



*Triumfi i dritës mbi*  
***ERRËSIRËN***



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Erzen Carja

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit  
Nr. 07 (494)  
Korrik, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

4 Triumfi i dritës mbi errësirën / Mehmet Disha

6 Mësime të vlefshme nga hixhreti profetik / Dorian Demetja

8 Lajme / Aktivitete



12 Zoti mes mëshirës dhe ndëshkimit / Jahja Sejd Ebu Mesamih

14 Udhëzimi i Profetit a.s. në bashkëjetesë me të tjerët / Prof. dr. Ali Xhum'a

18 Të ftosh në rrugën e Zotit / Lejla Dervishi

22 Dita e Ashuras një rast i volitshëm për shfrytëzim / Erjol Haxhiu

24 Gjeografia dhe Kur'ani / M.sc. Artan S. Mehmeti

26 Profeti që angazhoi në rrugën e tij çdo zemër besimtare / Halit Muharremi

30 Lartësimi dhe përhapja e qytetërimit Islam / Dr. Mozemil Haque



32 Torturat që hoqi i Dërguari ynë Fisnik në Taif / M. Jusuf Kandeheleui

34 Puna dhe prona në optikën e fesë Islame / Shpëtim Salihu

36 Hoxhë Hasan Moglica (1852-1915) / Personalitet

38 Unë të besoj o i Dërguari i Allahut / Redaksia



# Triumfi i Dritës mbi errësirën



Në fillim të çdo hëne të re të muajit Muharrem, jetojmë në përkujtimin e Hixhretit Profetik. Në brendësinë e qenies sonë ngjallet ndjenja e sakrificës dhe idealeve më të larta, shfaqet besimi i pastër, shkreptijnë rrezet e përpjekjeve dhe kumbon fuqishëm zëri i arsyes dhe i së vërtetës.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Në mos e ndihmofshit atë (Profetin), atë e ka ndihmuar Allahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin..." (Teube, 40)

Nga mundimet dhe persekutimet e mëdha që përjetonin myslimanët prej idhujtarëve, u detyruan që fshehtas, grupe-grupe ta linin Mekën dhe t'i drejtoheshin Medinës, për të gjetur shpëtim, prehje dhe qetësi, ku do të mundnin lirisht t'i shprehnin ndjenjat e tyre fetare. Mirëpo jobesimtarët i shqetësonte përhapja e dritës. Mundoheshin me çdo mjet e metodë ta shuajnë atë. Planet dhe orvajtjet e tyre Profetit ia zbuloi Krijuesi i gjithësisë, Allahu Fuqplotë, i cili në Kur'an thotë: "Përkujto (o Muhamed) kur ata që nuk besuan, thurnin (komplete) kundër teje, të të ngujojnë, të të mbysin ose të dëbojnë, ata bënin plane, e Allahu i asgjësonte (ato plane e kurthe), se Allahu është asgjësuesi më i mirë (i dredhive-intrigave)". (Enfal, 30)

Kështu, Profeti së bashku me shokun e tij Ebu Bekrin largohen nga Meka. I frikësuar për jetën e profetit, Ebu Bekri do t'i thoshte: "O i Dërguar, nëse të ndodh gjë ty, Islami do të fshihet nga faqja e dheut". Mirëpo si çdo herë, fjalët e Profetit do të ishin si balsam dhe do ta qetësonin Ebu Bekrin: "O Ebu Bekër, çfarë mendon për dy vetë, i treti i të cilëve është Allahu, prandaj mos u dëshpëro dhe mos u frikëso se Allahu është me ne, Ai na mbron dhe përkujdeset për ne".

Në të vërtetë ndihma dhe përkrahja e Krijuesit të gjithësisë, e cila asnjëherë nuk u ka munguar robërve të Tij të devotshëm, nuk mungoi edhe kësaj radhe. Në Kur'an lexojmë: "...e kur ata të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të tij: mos u pikëllo (dëshpëro), Allahu është me ne! E Allahu i zbriti qetësi (prehje) në shpirtin e atij, e furnizoi me një ushtri që ju nuk e patë..." (Teube, 40)

E më në fund, do të shndrisë dielli shkëlqyes e plot dritë i tij me tërë atë bukurinë magjepsëse.

Në Kur'an thuhet: "E fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ulëtën, kur fjala e Allahut është më e larta, sepse vetëm Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (Teube, 40)

Fjalët e Allahut janë më të lartat, sepse janë të shenjta; janë burim i pashtershëm i së vërtetës, i dritës dhe i udhëzimit; janë baza e moralit të përkryer, ashtu siç janë ideal i përhershëm i rrugës së shpëtimit dhe i fatbardhësisë njerëzore deri në amshim. Kurse fjalët e jobesimtarëve janë të ulëta, të pavërteta, të errëta dhe pa vlerë. Ato çojnë në humbje e në shkatërrim, në zhdukje e degradim. Fjala dhe Drita e Allahut do të plotësohen dhe përhapen pa marrë parasysh mërinë dhe urrejtjen e idhujtarisë.

Hixhret do të thotë: largim, shpërngulje, kalim, braktisje dhe ndarje nga diçka. Shpërngulja e bekuar e Muhamedit a.s nga Meka për në Medinë, me urdhër të Allahut të Madhëruar, ishte shpërngulje me qëllim kthimi, sepse i dërguari i Zotit, duke dalë nga Meka, me lot në sy tha: "Mekë, o vendlindja ime e shtrenjtë, kurrë nuk do të kisha lënë, po të mos më detyronin të të lë".

Ai kurrë nuk do ta harronte Mekën, derisa e çliroi njëherë e përgjithmonë nga prangat e idhujtarisë, tetë vjet pas hixhretit.

Kjo u bë e mundur, sepse hixhreti i Muhamedit a.s dhe i myslimanëve të tjerë, nuk ishte shpërngulje e "bijve dhe e shpirtrave të trazuar" nga frika për jetën e tyre, siç mund të përipiqet ta përshkruajë dikush, shpërnguljen e tyre të bekuar.

Hixhreti nuk ishte as ikje e as humbje e së vërtetës para urrejtjes hakmarrëse të jobesimtarëve, por ishte vendosmëri e paluhatshme dhe fillim i një rreshtimi të ri për thyerjen përfundimtare dhe ngushtimin e veprimit të jobesimtarëve; ishte rrugë e përhapjes dhe shtrirjes së dritës së besimit, dritë të cilën e kishin penguar idhujtarët plot trembëdhjetë vjet, me qëllim që ta zhduknin nga faqja e dheut.

Po qe se hixhreti do të ishte ikje nga frika, besimtarëve nuk do t'u arrinte ndihma dhe përkrahja e Allahut Fuqplotë, sepse Ai nuk i ndihmon e as nuk i lartëson frikakakët dhe të pavendosurit. Allahu dëshiron që besimtarët të jenë të fortë, të paepur e të vendosur në besimin dhe durimin e tyre.

Hixhreti ishte një planifikim i urtë dhe largpamës, ishte fillimi i një beteje ndërmjet dritës dhe errësirës, ishte shpërngulje e njerëzve drejt lirisë, fisnikërisë dhe dinjitetit, ngritje në çiltërsinë dhe dëlirësinë shpirtërore dhe shpëtim i ndërgjegjeve të pastra.

Hixhreti, në shikim të parë, ishte kalim nga një vend në një vend tjetër, kurse në esencë shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë, për një ardhmëri më të lumtur e më të shndritshme të Islamit.

Për këtë arsye Allahu i Madhëruar ia lejoi hixhretin të dërguarit të Tij. E rezultati nuk vonoi. Puna e parë e Muhamedit a.s. pas arritjes në Medinë, ishte vëllazërimi i myslimanëve – ensarëve (banorëve) të Medines dhe muhaxhirëve (të shpërngulurve) të Mekës, që u pasua nga ndërtimi i xhamisë, e cila do të ishte fanar ndriçues nga ku do të rrezatonin rrezet e dritës së udhëzimit të vërtetë. Në Kur'an thuhet: "Vërtet, Allahu do t'i ndihmojë atij që ndihmon (në) rrugën e Tij, se Allahu është Fuqplotë dhe i Plotfuqishëm". (Haxh, 40)

Përkujtimi i hixhretit në fillim të çdo viti, na bën më të ndërgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Allahut, në rrugën e thirrjes në Islam, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Na përkujton gjithmonë fitoren e lavdishme të Dritës ndaj errësirës, triumfin e besimit ndaj të kotës dhe të keqes.

Për këtë Allahu i Plotfuqishëm thotë në Kur'anin Fisnik: "Ai (Allahu) është që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë, për ta mbizotëruar mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë". (Saf, 9)

Besimtarët e ndershëm duhet ta jetojnë hixhretin, duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm (largim-shpërngulje) nga e keqja në të mirë, nga e pavërteta në të vërtetë, nga veprat e shëmtuara në ato të lavdëruara, nga koprracia në bujari, nga ngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhtia në besnikëri, nga dyfyturësia në sinqeritet dhe çiltërsi shpirtërore dhe nga robëria e mohimit në lirinë e besimit.

# Mësime të ulëfshme nga hixhreti profetik

Në Mekën e atyre kohëve, kur paria Kurejshe që kishte mbushur zemrën me dëshirat për pasuri, fëmijë, gra dhe pije e që s'mund të gjente vend për dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nisi ta mundonte Pejgamberin (a.s.) me sa i vinte për dore. I dërguari i Allahut pati dalë jashtë Mekës e pati shkuar në Taif. Por edhe populli i Taifit që sjellë si vëllezërit e tij të Mekës duke e vënë Profetin (s.a.s.) nën shiun e gurëve. Për këtë shkak, myslimanët mekas, duke iu përgjigjur ftesës së myslimanëve medinas si dhe me lejen e profetit, në pjesën e parë të shekullit VII, nisën të emigronin fshehtas nga dy e nga tre në Medine për të gjetur shpëtim, prehje e qetësi, ku lirisht mund të shprehnin ndjenjat e tyre fetare. Myslimanët mekas që emigruan nga Meka për në Medine, u quajtën muhaxhirë (emigrantë), kurse myslimanët medinas që i pritën këta si vëllezër dhe miq, i respektuan dhe i ndihmuan, u quajtën ensarë (ndihmëtarë). Kur'ani bën fjalë me dhjetëra herë për këto dy grupe që zënë një vend të rëndësishëm në historinë Islame.

Profeti Muhamed (s.a.v.) së bashku me shokun e tij të ngushtë Ebu Bekrin, emigruan të fundit. Medineja ishte ngritur në festë duke e pritur profetin me padurim, dashuri dhe hare. Kjo ngjarje e madhe me rëndësi në historinë Islame njihet me emrin Hixhreti Profetik dhe ky vit hënor quhet Viti i Ri Hixhri. Nisur nga rëndësia dhe roli i tij, myslimanët e kanë përcaktuar hixhretin si fillimin e kalendarit të tyre. Të gjitha ngjarjet historike më pas në fenë Islame u rënditën në bazë të kësaj pikënisjeje. Kështu mbyllet në historinë e Islamit periudha afro 13-vjeçare e Mekës e mbushur plot ngjarje të dhimbshme dhe niste periudha e Medines që do të vazhdonte 10 vjet, që do ta kthente Islamit në një rend politik, shoqëror dhe ekonomik, e që do t'i jepte Islamit shtetin e parë në historinë e tij.

## Rëndësia dhe roli i hixhretit

Fjala hixhret do të thotë: emigrim, shpërngulje,

braktisje dhe ndarje nga diçka. Hixhreti i Profetit Muhamed (s.a.s.) dhe i myslimanëve nuk ishte ikje nga frika për jetën e tyre, por një sakrificë e madhe realizuar vetëm për hir të Allahut dhe në shërbim të besimit. Myslimanët mekas lanë pas pjesëtarë të familjes, shtëpi, kopshte, mall, pasuri e tregti. Personi që emigroi për t'u martuar me Ummul Kajsin u quajt në përputhje me qëllimin e tij si "muhaxhiri i Ummul Kajsit." Kjo përveç se pasqyron qartazi se hixhreti nuk është thjeshtë zhvendosje fizike nga një vend në një tjetër, por shpjegon se ai pasohet nga "pse"-të e braktiksjes së gjërave. Njeriut i takon vetëm ajo çfarë ai synon dhe ka për qëllim.

Pa dyshim, emigrimi i myslimanëve nuk është as i pari dhe as i fundit emigrim në historinë e popujve. Emigrime janë bërë edhe para, edhe pas tij. Por duhet theksuar që, ato emigrime janë bërë për shkaqe materiale si thatësi apo zi, fatkeqësi natyrore, luftë, frikë nga armiku ose për arsye ushtarake. Ndërsa hixhreti në esencë ishte shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë për një ardhmëri më të lumtur e më të ndritshme të Islamit. Për këtë arsye Allahu i madhëruar ia lejoi hixhretin të dërguarit të Tij.

Hapat e para të Pejgamberit (a.s.) në këtë drejtim ishin themelimi i xhamisë së parë në Kuba, i Sufasë brenda në xhaminë e Medines e njohur si xhamia e Pejgamberit (a.s.) dhe bashkimi i tërë njerëzimit, e cila fillon me bashkimin dhe vëllazërimin mes medinasve (ensarëve) dhe mekasve (muhaxhirëve). E para tregon bazën religjioze dhe hyjnore, e dyta bazën e dijes dhe të shkencës, kurse e treta paraqet nivelin më të lartë të një shoqërie kur ajo është e bashkuar, apo të paktën, kur tashmë njerëzit jetojnë duke e ndjerë veten të lirë. Kur një shoqërie i mungojnë këto elemente bazë, ajo përjeton kriza të ndryshme, sikurse janë krizat etike, shkencore, ekologjike, kriza e të qenurit me të vërtetë i lirë në të besuarit, në të shprehurit, në të jetuarit etj.

Me fjalë të tjera, qëllimi i Allahut Fuqplotë me hixhretin e realizuar nëpërmjet Pejgamberit (a.s.) ishte ngritja e nivelit shpirtëror tek njerëzit, përgatitja profesionale dhe zhvillimi i ndjenjës për një jetë të përbashkët dhe të integruar mes tyre.

Një rëndësi tjetër e hixhretit ishte se Islami u përhap më me shpejtësi. Më në fund, myslimanët, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ranë në qetësi dhe jetuan në siguri. Nëpërmjet hixhretit Pejgamberi (a.s.) ngriti shtetin Islam, shtetin e drejtësisë dhe të mirësisë, shtetin e dijes dhe të besimit, shtetin e virtutit dhe të moralit, shtetin e të drejtës dhe të devotshmërisë. Jo vetëm kaq, por thirrja e re e Profetit (a.s.) mbas hixhretit, solli njeriun e ri, njeriun e nderuar dhe të lirë.

### **Hixhreti ose largimi nga mëkatet**

Ç'është e vërteta, në kuptimin e vet specifik, hixhreti ka marrë fund, sepse i dërguari i Allahut thotë: "Pas triumfit të Mekës nuk ka më hixhret."<sup>1</sup> Por në kuptim të përgjithshëm, hixhreti vazhdon dhe do të vazhdojë gjer në kiamet. Çdo burrë i kauzës, çdo njeri që ka besuar, i cili lë vendin e vet, nënën, babanë, të dashurit e miqtë dhe shkon vend më vend me synimin për t'u treguar të drejtën dhe të vërtetën zemrave nevojtare, ndodhet në kuadrin e dobishëm të një hixhreti, emigracioni të pambarim dhe pa asnjë diskutim që do ta marrë sevapin dhe të mirën e kësaj pune.

Do të ishte e dobishme që ta hapnim edhe këtë specifikë, që emigranti më i madh është ai që largohet prej mëkateve dhe që i fshin prej zemre të gjitha dashuritë përveç dashurisë për Allahun.<sup>2</sup> Të ikësh nga mëkatet e të trokasësh në portën e Zotit, e të mos largohesh nga ajo portë gjersa të vijë prej Tij fermani i faljes, është gjithashtu hixhret, emigrim. Një njeri, i cili pasi të ketë braktisur mëkatet e kryera më parë, rikthimin tek të njëjtat mëkate e quan më të dhimbshëm

se hyrjen në ferr, është vazhdimisht në rrugën e hixhretit, emigracionit, në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Njeriu që i sheh si një arë e minuar gurët e kufirit të gjërave të ndaluara, që u themi "haram" dhe që nuk afrohet gjer atje, që u kushton kujdes dorës, këmbës, syrit, veshit, gojës dhe buzëve të veta, do të thotë se bën hixhret gjatë gjithë jetës. Edhe sikur të rrijë mes njerëzve, edhe sikur të tërhiqet në vetmi, emigrimi i shenjtë do t'i jetë bashkudhëtar besnik në thellësitë e botës së tij ndjesore.

Koha në të cilën jetojmë është e mbushur me ndodhi, raste e fenomene që na i kanë lodhur sytë duke i parë, veshët duke i dëgjuar, mendjen duke i menduar dhe në fund, asgjë për njeriun. E ç'është më e keqja, nga kjo lodhje ende nuk ka shpresë se njeriu do të arrijë momentin e çlodhjes. Ky presion psikik, kjo torturë amorale dhe çnjerëzore shihet në mosarritjen e një integritimi të nevojshëm, gjerësisht të dobishëm, të një bashkimi mbarënjëzësor, të një respekti reciprok dhe kështu me radhë, e cila do të ketë për bazë hyjnoren dhe të shenjtën. Për këtë arsye duhet të jemi plotësisht të bindur se përkujtimi dhe rikujtimi i gjërave me vlerë hyjnore në histori, sikurse është hixhreti i Muhamedit (s.a.s.), janë më se të nevojshme.

Përkujtimi i hixhretit në fillimin e çdo viti, na bën më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Allahut, në rrugën e thirrjes në Islam, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Besimtarët e ndershëm duhet ta jetojnë hixhretin duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm nga e keqja në të mirë, nga e shtrembëra tek e vërteta, nga ngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhëtia në besnikëri, nga dyfytëria në sinqeritet dhe çiltërsi shpirtërore.

**Dorian Demetja**

1. Buhari, Xhihad, 1; Muslim, Imare, 85.

2. Buhari, Iman,4; Ibn Maxhe, Fiten, 2.



## 1

## SEMINAR INFORMUES RRETH HAXHIT

Zyra e Haxhit pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi një seminar informues mbi rëndësinë, mirësitë dhe kushtet e haxhit me besimtarët që pritet të nisen drejt vendeve të shenjta këtë vit për të kryer këtë ritual.

Koordinatori i haxhit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, së bashku me dy imamët, Erjol Haxhiu, Shpëtim Seranaj, si dhe me përfaqësues të stafit mjekësor që do të udhëtojnë me besimtarët, ndanë me të pranishmit udhëzimet dhe porosinë e fundit para nisjes.

Një pikë tjetër e këtij seminari ishin edhe veshja e ihramit, specifikat e qëndrimit në Mina, Arafat, Muzdefilfe, hedhja e gurëve në xhemarat, kryerja e tavafit, saji ndërmjet kodrave Safa-Merve, shkurtimi i flokëve, etj.

Ky seminar u zhvillua në dy data të ndryshme, i pari më 1 qershor në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër", ndërsa i dyti u zhvillua ditën e djeshme në Medresenë e Tiranës, po ashtu ky seminar u transmetua nëpërmjet platformave online për të gjithë besimtarët që nuk mundën të merrnin pjesë fizikisht.

Më herët edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një takim me murshidët që do të udhëheqin haxhinjtë e këtij viti në Mekke dhe Medine.

Në fjalën e tij drejtuar murshidëve, kryetari Spahiu, theksoi rëndësinë dhe veçantinë e shërbimit ndaj mysafirëve të Zotit, si në aspektin fetar po ashtu edhe në atë institucional.







## 2

**KMSH DHE "MIRËSI PËR BOTËN" FIRMOSIN FAZËN E II-TË TË PROJEKTIT PËR MBËSHTETJEN E IMAMËVE**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim z. Mohummed Umar Sayed, Kreu i Organizatës "Mirësi për botën".

Gjatë këtij takimi Gjatë këtij takimi, kryetari Spahiu dhe z. Sayed firmosën fazën e dytë të projektit për mbështetjen e imamëve, me synim zhvillimin e aktivitetit fetar në xhami të ndryshme të vendit.

Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, e falenderoi z. Sayed për mbështetjen e treguar si dhe vlerësoi përpjekjen e organizatës "Mirësi për Botën".

Kryetari Spahiu shtoi se nënshkrimi i këtij projekti vjen falë bashkëpunimit të shkëlqyer mes KMSH dhe organizatës "Mirësi për Botën" në projektet e mëparshme.

Z. Sayed e falënderoi Kryetarin e KMSH-së për bashkëpunimin dhe gadishmërinë e treguar në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshë në shërbim të besimtarëve.

Gjatë takimit palët shprehën vullnetin e tyre që ky bashkëpunim të zhvillohet edhe në faza të tjera në të ardhmen.





### 3

#### BESIMTARËT MYSLIMANË FESTOJNË KURBAN BAJRAMIN

Besimtarët myslimanë kanë nisur sot që në orët e para të mëngjesit të festojnë Kurban Bajramin.

Ceremonia kryesore e faljes u zhvillua në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, ku mijëra besimtarë myslimanë falën namazin e Kurban Bajramit dhe qindra mijëra të tjerë kanë festuar dhe kryer faljen në sheshet e çdo qyteti të vendit.

Para faljes së namazit të Kurban Bajramit, besimtarët ndoqën një program të shkurtër, program i cili filloi me këndimin e një pjese të Kur'anit Famëlartë nga imami i xhamisë "Et'hem Bej", z. Elton Karaj.

Ceremonia vazhdoi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili uroi besimtarët myslimanë dhe gjithë shqiptarët kudo që ndodhen për festën e Kurban Bajramit.

"Le të shërbejë kjo festë si fillimndryshim i madh për ne, si një pikënisje për reformim shpirtëror dhe kulturor, duke u bërë më të përkushtuar për Krijuesin dhe më të lidhur me njëri-tjetrin. Kështu, duke pasur Krijuesin synim dhe duke parë në tjetrin përgjegjësi, ne mund të kthehemi në shoqëri shembullore, në shoqëri ku vlerat janë imazhi më i theksuar i saj"- u shpreh z. Spahiu.

Ndërsa nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, mbajti ligjëratën para faljes së namazit të Kurban Bajramit ku theksoi se kjo është dita e vëllazërisë, solidaritetit, gëzimit dhe lutjes.

Programi kulmoi me faljen e namazit të Kurban Bajramit, ku mijëra besimtarët e mbledhur në bulevard i priu kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, për të vazhduar më pas me hutben e Bajramit, e cila u mbajt nga Myftiu i Tiranës, z. Gazment Teqja.

Në fund, besimtarët shkëmbyen mes tyre urimet më të përzemërta për këtë festë të dashurisë dhe sakrificës.

Mes urimesh dhe lutjesh besimtarët u larguan nga sheshi për të kryer obligimin e prerjes së kurbanit si dhe për të kryer vizita tek të afërmit e tyre.





# 4

## PRITJET ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT

Sot, pas përfundimit të programit të Kurban Bajramit në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizita me rastin e kësaj feste.

Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman ishin, drejtues të institucioneve shtetërore, lokale, përfaqësues të subjekteve politike, ambasadorë, personalitete të jetës publike, përfaqësues të organizatave të ndryshme, të fushës së artit, biznesit, etj.

Pjesë e kësaj dite të begatë e festive u bënë edhe drejtues të komuniteteve fetare si dhe përfaqësues të tarikateve.

Në mesazhet e tyre drejtuar Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ata shprehën urimet dhe përhëndetjet e tyre të sinqerta si dhe uruan besimtarët për më shumë mirësi në familje dhe shoqërinë tonë të përbashkët.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.



# Zoti

## mes mëshirës dhe ndëshkimit

Shpesh herë e gjejmë veten mes perceptimit të Zotit si të Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëbërës dhe perceptimit tjetër si hakmarrës dhe me ndëshkim të ashpër.

Ashtu siç edhe na ka njoftuar Zoti në Librin e Tij, mëshira e Tij prevalon ndaj ndëshkimit dhe urtësia ndaj zemërimit. Mirësitë dhe begatitë e Tij mbulojnë çdo skaj të jetës së njeriut. Atëherë, çfarë do të thotë që ndëshkimi i Zotit është i ashpër?

Thotë Zoti në Kuran: "Vallë, a nuk është Xhehenemi vend për ata që janë mendjemëdhenj?!" (Zumer 60)

"Vendbanimi i tyre është zjarri e sa vendstrehim i shëmtuar është ky për keqbërësit!" (Al Imran, 151)

Duhet të kemi parasysh se Zotit nuk i shkaktohet asnjë dëm nëse njerëzit të gjithë besojnë, apo të gjithë e mohojnë.

"Sikur që nga i pari prej njerëzve dhe xhindeve, të ishin sipas zemrës më të devotshme prej jush, kjo nuk do e shtonte pushtetin tim. Sikur që nga i pari prej jush dhe xhindeve të ishte si zemra më e ligë e njërit prej jush, kjo nuk do e pakësonte aspak pushtetin tim." Hadith kudsij.

Por, Zoti hakmerret dhe ndëshkon kur përdhosen dhe shkelet dinjiteti e nderi i njeriut, kur njeriu të cilin e zbriti në tokë dhunohet padrejtësisht, Ai ndëshkon kur njeriu bën padrejtësi, sillet me arrogancë dhe prish rregullin në tokë.

“botën tjetër do ua japim atyre që nuk sillen me arrogancë në tokë dhe nuk prishin rendin.”

Besimi tek Zoti kalon nga njeriu dhe përgënjeshtrimi i Zotit është përgënjeshttrim i njeriut.

Po të studiojmë Kuranin, do të gjejmë se Zoti tregon histori si i ka shkatërruar dhe ndëshkuar zullumçarët dhe diktatorët, ndërkohë që nuk e bën të njëjtën gjë me gjynahçarët dhe mëkatarët.

Ebu Lehebi dhe e shoqja lëndonin dhe keqtrajtonin një njeri në tokën e Zotit, prandaj dhe ata u përjetësuan nga histori si një kujtim i keq. “Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka! Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara, po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit, në qafën e saj do të ketë një litar prej fjesh palme.” (Mesed)

Zoti nuk e përmend askënd i cili nuk i ka besuar Muhamedit a.s, ka parë hallin e tij dhe nuk i ka hyrë në hak askujt.

Historia e Faraonit nuk zë aq hapësirë të madhe në Kuran vetëm sepse nuk besonte tek Zoti i qiejve dhe tokës. Si ai, kishte edhe shumë njerëz të tij të cilët nuk besonin tek Zoti. Por emri i tij përmendet në Kuran sepse e kishte shpallur veten si zot që adhurohej dhe u kërkonte njerëzve që ta adhurojnë. Këtë e bënte me forcën e shpatës, duke i keqtrajtuar burra e gra. Prandaj fitoi dhe mallkimin e Zotit deri në ditën e Gjyqit të madh.

Abdullah ibnu Ubej ibnu Selul ishte si të gjithë mynafikët e tjerë, të cilët fshihnin mosbesimin dhe deklarimin besimin. Por, në dallim nga të tjerët, ai bënte çmos që mes besimtarëve myslimanë të përhapë ligësinë, ai shpifi për nderin e nënës së besimtarëve. Padrejtësia e tij e kaloi kufirin e vetes për tek të tjerët tashmë, prandaj dhe historia e tij lexohet dhe do të këndohet deri në ditën e Kiametit.

Po, Zoti ka ndëshkim të ashpër për një pjesë të kufizuar njerëzish arrogantë në tokë, dëmi i të cilëve e kalon veten e tyre dhe bie mbi njerëzit e tjerë.

Zoti në Kuran thotë: “Vallë, a nuk është Xhehenemi vend për ata që janë mendjemëdhenj?!” (Zumer 60), dëmi i të cilëve bie mbi të tjerët dhe nuk ka përmendur ata që bëjnë gjynahe, dëmi i të cilave bie mbi vetë individin dhe jo të tjerët.

Të gjithë popujt e mëparshëm pësuan dobësim dhe rrënim, duke u bërë mësim për të tjerët sepse: “Ata i përgënjeshtroan të mirat e Zotit” duke cenuar drejtësinë, paqen, sigurinë dhe lirinë. Ata vendosën diktatura në tokë duke ua nxirë jetën njerëzve.

“botën tjetër do ua japim atyre që nuk sillen me

arrogancë në tokë dhe nuk prishin rendin.” dhe jo sepse ata nuk besuan në Zotin dhe nuk zbatuan ligjet e Tij.

“Kur duam ta shkatërrojmë një vend, urdhërojmë njerëzit e shfrenuar të tij që të bëjnë ligësi dhe me ta merituar, i shkatërrojmë plotësisht.”

“Thuaj, lëvizni në tokë dhe shiheni si ishte fundi i përgënjeshtresve”

Historia na tregon se ata që përgënjeshtrojnë mesazhin e mëshirës dhe cenojnë drejtësinë dhe ligjet e paqes, edhe pse mund të jenë monoteistë dhe adhurues të një Zoti të vetëm, shumë shpejt i përkasin të shkuarës për shkak të padrejtësive.

Le të marrim si shembull Bashkimin Sovjetik, i cili përgënjeshtroi mesazhin e mëshirës, shkeli me këmbë parimin e drejtësisë dhe korri jetë njerëzish padrejtësisht! Brenda disa dekadave u kthye në rrënoja, ndërkohë që dukej sikur do të arrijë retë.

Dinastia abasite ishte aq e madhe saqë lideri i saj politik u drejtohej reve me fjalët: “Shkoni e lëshoni shi ku të doni, pasi kudo që ta lëshoni shiun tuaj do më vijë haraçi.” Ku është tani kjo dinasti?!

Nga ana tjetër, le të shohim vende si Suedia, i cili i ka besuar fort parimit të mëshirës, ka instaluar drejtësinë dhe ka përhapur paqen. Vende të tilla Zoti i ka begatuar me siguri dhe të mira pafund, të cilat u vijnë nga qielli dhe nga toka. Një vend i tillë i cili i ka besuar deri në verbëri parimit të drejtësisë, ka mbi 150 vite që nuk ka dëshmuar luftë në tokat e veta.

Ibnu Tejmije ka një thënie të artë lidhur me këtë koncept, ku thotë: “Zoti e ndihmon një shtet të drejtë, edhe pse mund të jetë jobesimtar, por nuk e ndihmon një shtet të padrejtë edhe pse mund të jetë besimtar.”

Usulistët kanë një parim sipas të cilit: “Kudo ku ekziston drejtësia, aty është ligji i Zotit.”

Kur ta kuptojmë siç duhet versetin uranor “Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt.” (Hadid, 25), asokohe do të kuptojmë se Zoti e shpërblen butësinë, ashtu siç nuk e shpërblen dhunën. Nuk mund të bëhet fjalë për drejtësi aty ku flet dhuna.

Nëse ndërgjegjësohemi për këtë, asokohe do të ndërgjegjësohemi se Zoti është i Gjithëmëshirshëm për të gjithë dhe se ndëshkimi i Tij përfshin vetëm një pjesë e cila rebelohet ndaj natyrës së pastër me të cilën e krijoi Zoti njeriun. Në vargjet e para të Kuranit, lexojmë: “Me emrin e Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Falënderimet janë vetëm për Zotin e botëve.”

Triumfi i vërtetë do u përkasë robërve të përzgjedhur të Zotit, të cilët urdhërojnë për drejtësi dhe ftojnë në paqe!

**Jahja Sejid Ebu Mesamih**

# UDHËZIMI I PROFETIT (A.S.) NË BASHKËJETESË ME TË TJERËT

**“Në të dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”**  
(Ahzabë, 21)

I dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, na ka lënë neve katër modele në lidhje me bashkëjetesën me të tjerët. Njëri prej tyre është modeli që ka ekzistuar në Mekën e Ndritur kur situata atje ishte “durimi dhe bashkëjetesa”. Modeli i dytë është modeli i qëndrimit të myslimanëve në Habeshe dhe situatë atje ishte “besëlidhja dhe kooperimi”. Modeli i tretë është modeli i Medinës në etapën e parë të saj dhe situatë atje ishte “çlirimi dhe bashkëpunimi”. Modeli i katërt ishte ai i Medines në etapën e fundit të saj dhe situatë atje ishte “drejtësia” dhe “vetëdija para përpjekjes”.

Qëndrimi i myslimanit në shoqëri nuk del jashtë këtyre katër kontureve. Është obligim yni që të përfitojmë shumë nga secili prej këtyre modeleve të paraqitura duke patur parasysh se është një

metodologji e zgjedhur vetë nga Allahu i Lartësuar. Është detyrë e jona që t'i perceptojmë realitetet e këtyre modeleve, që janë të vlefshme e të dobishme për myslimanin në çdo situatë e rrethanë, e të kuptojmë traditën e të Dërguarit tonë, paqja qoftë mbi të!, përmes rrjedhës historike dhe pozitive të tij.

Nga ajo që na transmetohet me saktësi nga Ibn Habbani, i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, ka thënë: “Nga mençuria e familjes së Daudit është që besimtari të jetë perceptues i çështjes së tij dhe i njohur me kohën e tij”. Në Mekë, qeverisja dhe anëtarët e saj ishin politeistë, kurse myslimanët ishin në opozitë. Populli e urrente Islamit dhe myslimanët dhe i dëmtonte ata.

Qeverisja në Habeshe ishte jo myslimane, por ajo ishte e drejtë dhe i respektonte pakicat, përfshi këtu myslimanët, duke i siguruar atyre të drejta dhe liri.

Në Medine në etapën e parë qeveria ishte myslimane, por popullsia ishte e përzier, mes tyre Kishte çifutë, politeistë, paganë, hipokritë dhe



muslimanë.

Në Medine në etapën e fundit, u pakësua kjo llojshmëri ku nuk mbeti asnjë nga politeistët, por mbetën shumë çifutë, bazuar në të dhënat e sakta të historisë.

#### **Modeli i Mekës: Durimi dhe bashkëjetesa**

Xha'fer bin Ebi Talib r.a. jep këtë panoramë për Mekën para islame në fjalën e tij të njohur përpara Nexhashit: "O mbret, ishim një popull i paditur, adhuronim idhuj, hanim ngordhësirën, vepronim gjëra të turpshme, i bënim keq fqinjit dhe më i forti nga ne hante të dobëtin..." (Transmetoi Ahmedii)

Profeti (a.s.) pati bashkëjetuar me atë popull e me të keqen e tyre, duke vazhduar kryerjen e detyrave të tij – nëse më lejohet një përshkrim i tillë – në mesin e tyre. Këtë situatë e përshkruan Znj. Hatixhe, nëna e besimtarëve, e cila i drejtua atij: "Në asnjë mënyrë, përgëzo, se Allahu nuk të turpëron kurrën e kurrës, pasha Allahun ti do ta

vësh nderin në vend, do mahnitësh bisedën, do mbartësh barrën, do fitosh mosekzistencën, do përforcosh të dobëtin e do stabilizosh e garantosh episodet e së vërtetës." (Transmetoi Buhariu)

Profeti, paqja qoftë mbi të!, bëri aleancë me fiset e Kurejshëve, kur u zotuan në triumfin e padrejtësisë, i ftoi fiset në një aleancë në shtëpinë e Abdullah bin Xhud'an si ndër më fisnikët dhe aleanca u bë ndërmjet Benu Hashim, Benu El-Muttalib, Esedu bin Abdul-Uzej, Zehretu bin Kilab dhe Tejmu bin Mureh. Ata ranë dakort që askujt brenda Mekës të mos i bëhet padrejtësi, përndryshe ata do të bashkoheshin me të, deri sa personit t'i kthehej e drejta e tij. Këtë aleancë Kurejshët e quajtën "Aleanca e Mirësisë".

Në lidhje me këtë Profeti ynë, paqja qoftë mbi të!, ka thënë: "Jam dëshmitar – në shtëpinë e Abdullah bin Xhud'an – i një aleance e cila ka qenë më e dashur për mua se ornamentet e deveve, dhe nëse do të ftohesha me të në Islam, do të përgjigjesha".

Profeti e ka mbajtur këtë aleancë edhe pas misionit, drejtonte me të e vepronte me përmbajtjen e saj deri sa atë e thyen Kurejshët.

Detyra jonë si myslimanë është që të jemi si i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi tël, nëse ndodhemi në një mjedis siç ishte ai në Mekë, të duruar e të bashkëjetojmë, pasi shumë thënie profetike e sigurojnë një gjë të tillë. Profeti duronte e bashkëjetonte dhe nuk i linte parimet, edhe pse mjedisi që e rrethonte atë nuk ishte i përshtatshëm.

Vëmë re se ata të cilët refuzuan bashkëjetesën e kuvendonin për persekutimin e myslimanëve ishin politeistët. I dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi tël, vazhdonte të falej në Qabe në kohën që aty gjendeshin më shumë se treqind e gjashtëdhjetë idhuj. Megjithatë ai nuk u përpoq të shkatërronte asnjë idhull prej tyre, pavarësisht se ato ishin kundër mesazhit të dëlirë me të cilin ai erdhi? Është detyra jonë që të thellohemi në përshkrimin e pozitës së të dërguarit të Allahut në Mekë e të deduktojmë nga çdo paragraf diçka që e ndihmon myslimanin të cilit i është caktuar të jetojë në një shoqëri që e urren Islamin dhe myslimanët.

#### **Modeli habeshian: Besëlidhja e kooperimi**

Në modelin e dytë në shoqërinë Habeshite për të cilën i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi tël, ka thënë pasiqë e pa dëmin që i kanosej bashkëkohësve të tij: "Sikur të dilnit në tokën e Habeshitëve, sepse atje është një mbret madhështor që nuk i bën padrejtësi askujt". Të parët që vajtën atje ishin: Osman bin Afani me bashkëshorten e tij Rukije, vajzën e të dërguarit të Allahut, Zubejr bin Avvam, Abdurrahman bin Auf, Xha'fer bin Ebi Talib e shumë sahabë të tjerë. Profeti iu tha: "Derisa Allahu t'ju mundësojë juve rrugëzgjdhje e rrugëdalje..." (Transmetoi El-Bejhaki)

Fjala e Xha'fer bin Ebi Talib r.a. para Nexhashiut, është një fjalim elekuent, që ka nevojë për studime të gjata, ka nevojë që të deduktojmë prej saj dispozita që i sjellin dobi myslimanit në këto vende, në të cilat ekzistojnë qeveri të cilat nuk i kundërvihen Islamit, i ndihmojnë myslimanët

e i duan ata si nënshtetasit e tyre... Si veprojnë dhe si ndërveprojnë? Cili është koncepti i nënshtetësisë? Madje edhe në kohën moderne ... të gjitha këto mund të merren nga eksperiencia e Habeshijve.

#### **Modeli i Medines në etapën e parë: Çlirimi dhe bashkëpunimi**

Nëse shkojmë në Medinen e Ndritur të asaj kohe do të gjejmë se ajo përbëhet nga çifutë, politeistë, hipokritë e myslimanë dhe në secilën prej këtyre shoqërive ka dispozita juridike të cilat nuk bien poshtë nëse nuk e lexojmë historinë dhe traditën e Profetit, paqja qoftë mbi të. Do të veçoja diçka të bukur këtu dhe ajo është se në kohën kur Profeti, paqja qoftë mbi tël, emëroi Sa'd bin Muadh tek çifutët... ky është një sistem gjyqësor të cilin njerëzimi nuk e ka arritur ende në ditët e sotme dhe ky është të zgjedhë i akuzuari gjykatësin e tij. Duhet të dimë që ishte një vendim gjyqësor për krimin e tradhtisë së madhe.

Nuk mundet të klasifikohet për asgjësimin e një shoqërie e as për asgjësimin e një populli, por përkundrazi u ndërtua mbi sistemin e ligjit legjitim dhe marrëveshjeve me konsensus siç ishin në fletoren zyrtare të Medines.

Në këtë aspekt shohim se si ka qenë çështja e paqes për njerëzit e librit dhe kontradiktat e dijetarëve për të, dhe ka qenë Sufjan bin Ujejne dhe El-Evzajij e të tjerë në mbrojtje të paqes e kjo për një shkak e një qëllim: shmangien e ngatërresave, sepse ato duke ecur thonin "Es-Samu Alejkum" – "helmi mbi ju" d.m.th. shkatërrim për ju.

Ndërsa me hipokritët, mjafton që Allahu i Lartësuar e lejoi vrasjen e tyre megjithëkëtë Profeti nuk vrau asnjë prej tyre. Ai shprehej: "Mos të thonë njerëzit që Muhamedi vret bashkëkohësit e tij" (Transmetoi Buhariu). Ndërsa në suren Ahzabë thuhet: "**Nëse nuk i japin fund hipokritët e ata të cilët në zemrat e tyre kanë sëmundje dhe të njollosurit në Medine, do të provokojnë ty me to e më pas nuk do të afrohen më me përjashtim të një pakice. Të mallkuar, kudo që të jenë edukuar, u morën e u vranë barbarisht.**" (Ahzabë, 60-61)



Ekziston një dallim ndërmjet lejimit dhe ekzekutimit, ndërmjet të lejuarës e të dhënës. Ky është një mësim që e mësojmë nga i Dërguari ynë, paqja qoftë mbi të. Nuk është e vërtetë absolutisht që Islami apo myslimanët njohin e pranojnë spastrimin etnik, njësimin e fesë, urrejtjen e njerëzve për të hyrë në fenë e tyre apo përzënien nga tokat e tyre... kjo nuk ka ndodhur kurrë, as në kohën e Profetit dhe as në historinë e pastër islame.

### **Modeli i Medines në etapën e fundit: Drejtësia dhe vetëdija para përpjekjes**

Modeli i katërt është ai i Medines në etapën e saj të fundit. Këtë e sqaron një thënie e Buhariut në të cilën thuhet: "Profeti ndërroi jetë dhe mburoja e tij ishte peng tek një çifut për tridhjetë Sa'a (masë matëse e barabartë afërsisht me 2.3 kg) elb".

U grindën një mysliman dhe një çifut, dhe myslimani thotë: Pasha Atë që zgjodhi Muhamedin nga të gjithë botët, ndërkohë që çifuti thotë: Pasha Atë që zgjodhi Musain nga të gjithë botët. Në këtë moment myslimani e qëllon me shuplakë çifutin. Çifuti shkon tek i dërguari i Allahut dhe e njofton për çfarë ndodhi mes tyre. Me këtë rast Profeti, paqja qoftë mbi të!, tha: "Mos më diferenconi në zgjedhje mua me Musain, sepse njerëzit ringrihen ditën e ringjalljes dhe do të jem i pari që do të ngrihem, e ndërkohë Musai është i shtrirë pranë fronit, dhe se nuk e di a është prej atyre që ringjallen e ngrihet para meje apo është nga ata që Allahu ka bërë përjashtim." (Transmeton Buhariu)

Ndërmjet Ta'meh bin Umejr nga myslimanët dhe Zejd bin Semijn nga çifutët ndodhi një ngatërrësë dhe i padrejti në këtë rast ishte myslimani, dhe për këtë zbriti thënia e të Lartësuarit: "**Mos debato për ata të cilët anojnë nga vetja e tyre, se vërtet Allahu nuk i do ata që janë arrogantë e mëkatarë**" (Nisa, 107). Këtu drejtësia e Profetit, paqja qoftë mbi të!, ishte në krahun e çifutit kundër myslimanit, sepse drejtësia është baza e posedimit dhe sepse Zoti dëshiron që të na nxjerrë neve nga errësira në dritë: "**Dhe mos ndërmerrni ndonjë ofensivë ndaj një populli e të**

**bëni padrejtësi, bëni drejtësi sepse ajo është më afër devocionit.**" (Maide, 8). Mësuam parimet, mësuam moralin dhe mësuam që sikur t'i hidhnin një sy të gjitha botët do t'i besonin atij, paqja qoftë mbi të!

Profeti, paqja qoftë mbi të!, na mësoi durimin, na mësoi si të ndërveprojmë me njerëzit me butësi, duke mos imponuar tek ata mendimet dhe bindjet tona.

Profeti, paqja qoftë mbi të!, ka bashkëjetuar deri edhe me njerëzit më të këqij... Aishja r.a. tregon se një burrë i kërkoi leje Profetit dhe në momentin që e pa atë, ai tha: "Sa i keq është vëllai i klanit, sa i keq është biri i klanit". Kur personi në fjalë u largua, Aishja r.a. tha: O i dërguari i Allahut, në momentin që e pe burrin i the kështu e kështu. Kurse i dërguari i Allahut iu përgjigj: "O Aishe, kur më ke njohur mua kaq të pahijshëm, ndër njerëzit më të këqij në gradë tek Allahu ditën e ringjalljes është ai i cili i lejon njerëzit të vazhdojnë të qëndrojnë në të keqe." (Transmetoi Buhariu)

Çdo fjalë, sjellje apo veprim i Profetit, paqja qoftë mbi të!, përmban në vetvete rregulla, parime e metodika, të cilat mund t'i gjallërojmë në epokën tonë e mund t'i zbatojmë në realitet.

Është obligimi ynë që të studiojmë historinë, traditën e rrugën e të dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të!, në të njëjtën koordinatë, të përpiqemi të deduktojmë prej tyre përbërës të personalitetit mysliman, për të kuptuar çështjet, përballjen e tij me botën, në jetesë, pjesëmarrje, mirëkuptim, bashkëpunim, adhurimin e Allahut, ndërtimin efikas në tokë dhe pastrimin e qenies humane, derisa të bëhet sikur e ka marrë Profetin, paqja qoftë mbi të!, si shembullin më të mirë, e derisa të realizojë besueshmërinë e nderin në pozitën e dëshmitarit mbi botët: "Kështu pra ne ju bëmë juve një komb të mesëm, në mënyrë që të jeni dëshmitarë mbi njerëzinë, e të jetë i Dërguari për ju dëshmitari absolut".

**Prof. dr. Ali Xhum'a**

# Të ftosh në rrugën e Zotit

## Myslimani në shoqëri

Shpesh dëgjojmë se dikujt i dëgjohet fjala apo i përgjigjen njerzit, fjalët e tij kanë ndikim magjik në shpirt dhe ai arrin ti ndryshojë njerzit për mirë e ti ndreqë ata.

Atëhere thuhet se “filani ka influ-encë”, apo “është një personalitet ndikues”.

Nuk ka dyshim se kjo influencë është shumë e rëndësishme. Para së gjithash duhet thënë se influenca është dy llojesh, pozitive dhe negative dhe ne do të flasim për influencën pozitive.

Çfarë nënkuptojmë me influencë pozitive? Me të nënkuptojmë nevojën që kanë njerëzit për shkollimin e injorantëve, korrigjimin e gabimtarëve, dekurajimin e mëkatarëve dhe të tjera si këto mjete që shërbejnë për të udhëzuar njerëzit drejt mirësisë dhe prosperitetit. Pra do të flasim rreth faktit se si duhet ta bëjmë më të efektshme thirrjen dhe udhëzimin e njerëzve. Fillimisht elementet e influencës përqendrohen në tre çështje kryesore:

- 1-Prirja, tërheqja ndjesore dhe pranimi me gjithë shpirt.
- 2-Bindja me anë të argumentave shkencore.
- 3-Shembulli i gjallë.

Shkurtimisht themi se njerëzit pranojnë vetëm fjalët e atij të cilin e duan, që i tërheq, prandaj duhet patjetër të fitohet kjo tërheqje dhe ky pranim sepse ai shërben si mjete kryesor për të siguruar influencën mbi njerëzit dhe përgjigjen e tyre. Por sigurimi i simpatisë dhe i tërheqjes

se njerëzve nuk është gjithçka, pasi dikush mund ta dojë dikë, por nuk e ndjek atë sepse nuk është i bindur apo nuk e sheh të vërtetën për bindjen me forcën e arsyes dhe me anë të argumenteve shkencore, pasi ajo ka pushtet të padiskutueshëm.

Kështu duhet të dimë se këto mënyra janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Kështu, nëse do të kishim vetëm një tërheqje ndjesore pa bindjen, nuk do të kishte përgjigje pozitive ndaj asaj për të cilën bëjmë thirrje. Po ashtu edhe nëse do të kishim vetëm bindje me argumente shkencore, por të shoqëruara me një lloj vrazhdësie nuk do të kishim përgjigje.

Ndërsa faktor i tretë që është shembulli i gjallë mbështetet në dy faktorët e parë. Kështu ky faktor shton prirjen dhe tërheqjen ndjesore dhe i jep forcë e qartësi argumenteve logjike, duke bërë që të kemi ndikimin e kërkuar. Për të theksuar më shumë forcën e këtij faktori po citojmë Ibni Kajimin, i cili ka thënë për dijetarët e oborreve: Ata i ftojnë njerëzit në xhenet me fjalët e tyre dhe në xhehenem me veprat e tyre. Sa herë që fjalët e tyre u thanë njerëzve: “Ejani në xhenet” veprat e tyre ndërhyjnë duke thënë: “Mos i dëgjoni ata”.

Nëse fjalët e tyre do të ishin të vërteta, ata do të ishin parë që do t'i përgjigjeshin atyre...”

Në të vërtetë ne që të gjithë e duam ta kemi këtë ndikim, pasi shpesh dëgjojmë nga njerëzit se me gjithë fjalimet,



leksionet, mësimet e ndryshme, shihet se përgjigjja është jo ashtu siç pritet.

Ne kujdesemi të ndodhë ky ndikim për arsye të ndryshme si për shembull:

1-Shpërblimi i madh që na pret.

Profeti a.s. ka thënë: "Nëse Allahu udhëzon me anën tënde dikë, është më mirë se të kishe një pasuri të rrallë"; "Kush udhëzon për një punë të mirë ka shpërblim sa ai që e kryen atë punë." Ky shpërblim merret nëse ndodh praktikisht përgjigjja ndaj thirrjes.

2- Për shkak të këtij ndikimi fitojmë kënaqësinë e Allahut dhe na zbret fitorja prej Tij.

3-Një arsye tjetër është triumfi ndaj të keqes dhe njerëzve të saj, pasi ajo zotëron mjete dhe mënyra të ndryshme për të përhapur idetë dhe konceptet e saj. Kështu, detyra jonë është të tregohemi të vëmendshëm e t'i dalim kësaj të keqeje përpara.

Nga ana tjetër, kur thirrësi në Islam nuk ka ndikim tek njerëzit, tek ai krijohen paragjykime dhe mendime të gabuara për ta, duke thënë se ai u përpoq t'ia përcillte Islamit në mënyrë të qartë e me argumente, por njerëzit e refuzuan atë. Por gabimi mund të jetë tek ai vetë. Mospasja ndikim është e rrezikshme edhe për thirrësit pasi duke krijuar këto paragjykime, ai bie në një gjynah të madh siç na ka paralajmëruar Profeti a.s.: "Kush thotë: njerëzit morën fund, ai ka marrë fund për vetë" apo "ai i shkatërroi ata".

Gjithashtu prej mosndikimit rrjedh dhe diçka tjetër: ai që thërret duke mos qenë vërtet i përgatitur dhe nuk gjen përgjigje prej njerëzve, mund të bëhet pesimist dhe të largohet prej tyre. Kjo bën që të zvogëlohet numri i ftuesve në Islam.

Gjithmonë kur flasim për thirrjen në Islam duhet të kemi parasysh se kushti i parë për ndikim është forca e besimit.

Kështu ftuesi në Islam duhet të ketë besim të madh, frikë ndaj Allahut, t'i mbështetet gjithmonë Atij, ta ndiejë përherë mbikqyrjen e Tij, gjuha e tij të jetë përherë duke përmendur Allahun, mendja të jetë duke medituar në krijimin e Tij, zemra të përjetojë takimin me Të, të përpiqet për të bërë vepra të mira, të agjërojë ditën e të falet natën, të jetë i sinqertë dhe të kërkojë që çdo vepër e tij të jetë për Allahun. Kështu nëse ai ka disa ose më shumë prej këtyre cilësive do të ketë njëfarë pranimi nga njerëzit.

Profeti a.s. ka thënë: "Nëse Allahu do një rob të Tij, i thërret Xhibrilit dhe i thotë: O Xhibril, Unë e dua filanin prandaj duaje dhe ti." E Xhibrili e do atë. Pastaj Xhibrili thërret banorët e qiellit e u thotë: "Allahu e do filanin prandaj duajeni atë" dhe ata e duan. Pastaj atë e duan edhe banorët e Tokës."

Pranimi fillestar nuk vjen nga elokuenca e fjalëve apo forca e argumenteve, por vjen nga sekretet e sekreteve që është sinqeriteti ndaj Allahut xh.sh dhe nënshtrimi i plotë ndaj Tij. Me këtë cilësi të vyera ish-in pajisur dhe të parët tanë. Ata iu përkushtuan me sinqeritet fesë së Allahut,

iu nënshtruan Atij plotësisht dhe i mbushën zemrat me frikën e Allahut derisa vetëm pamja e tyre ishte një këshillë prekëse, rruga e tyre të kujtonte Ahiretin dhe vetëm disa fjalë të tyre hapnin dyert e zemrave duke thyer pengesat.

Ibni Mesudi r.a. i ka përshkruar kështu sahabët e Profetit a.s.

"Kush do të ndjekë ndonjë rrugë, le të ndjekë rrugën e atyre që shkuan sepse të gjallët mund të preken nga fitneja. E ata që shkuan janë shokët e Profetit a.s., njerëzit më të devotshëm të këtij umeti, më të thjeshtët. Me një fjalë të njërit prej tyre Allahu drejton grupe të tëra njerëzish. Me të vërtetë që këto janë fjalë që dalin nga thellësitë e zemrave, fjalë të veshura me ngrohtësinë e sinqeritetit dhe me dëshirën për t'i bërë mirë njerëzve, prandaj dhe japin frytet e tyre."

Duhet ta dini se të parët tanë nuk mbanin fjalime të gjata, por vetëm disa fjalë të pakta që kishin një ndikim të jashtëzakonshëm. Ky është dhe sekret i madh të cilin e ka vënë Allahu në fjalët e çdo udhëzuesi. Një herë u pyet Hasan Basri: Përse fytyrat e atyre që falen natën rrezatojnë dritë?" Ai tha: "Sepse ata qëndruan vetëm për vetëm me Allahun dhe Ai i veshi ata me dritën e Tij."

Kështu pra, çelësi kryesor për të hapur rrugën drejt zemrave dhe për të patur sukses në daua (thirrje) është përkushtimi dhe nënshtrimi i plotë ndaj Allahut, sepse ai që realizon këtë gjë ka përkrahjen e Allahut në çdo hap të tijin, nëse punon - punon mirë, nëse gjykon - gjykon drejtë, nëse flet - u fal dobi të tjerëve. Ky është shembulli i thirrësit, pamja e të cilit të kujton Allahun. E në këtë pikë duhet patjetër të ndjekim shembullin e Profetit a.s., i cili falej natën aq sa i fryheshin këmbët nga të qëndruarit gjatë në këmbë dhe kur Aishja r.a. i tha se pse e bënte këtë kur i ishin falur të gjitha gjynahet, ç'kishte bërë e çdo të bënte, ai iu përgjigj: "A s'duhet të jem rob mirënjohës?"

Profeti a.s. ishte ai që e kishte më shumë frikë Allahun nga të gjithë besimtarët e tjerë dhe thoshte: "Sikur ta dinit atë që unë di, do të qeshnit pak e do të qanit shumë." Ai dilte çdo natë nga Medina dhe vizitonte varrezat duke i përshëndetur të vdekurit sikur sapo kishte ardhur momenti për t'u ndarë nga kjo botë e për t'u bashkuar me ta. Profeti a.s. ishte njeriu më i lidhur me Allahun dhe më i larguar nga dynjaja. Të gjithë këta shembuj nga jeta e Profetit a.s. na tregojnë edhe njëherë se reagimi pozitiv ndaj mesazhit islam bazohet në radhë të parë tek faktori i besimit.

Faktori i dytë që ndikon te përgjigjja ndaj është bagazhi kulturor dhe shkencor i ftuesit në Islam.

Përkrah ndikimit me anë të devocionit dhe besimit duhet të jetë edhe ndikimi me anë të argumenteve dhe dialogut shkencor, i bazuar në dijen rreth Librit të Allahut dhe traditën e Profetit a.s. Është për këtë arsye që Profeti a.s. shëronte çdo të etur për dije me njohuritë që kishte për Allahun.

Te kjo dije njerëzit gjejnë përgjigjet e pyetjeve të tyre zgjidhjen e problemeve të tyre. Kjo dije është zahireja e çdo thirrësi. Ne anë të saj thirrësi ndriçon shikimet e njerëzve,

ndreq konceptet e tyre, u mëson atyre të vërtetat e mëdha të Islamit dhe të vërtetat e realitetit në të cilin jetojnë.

Pra dija është një nga anët kryesore të thirrësit në Islam për të tërhequr njerëzit pas vetes, pasi për çdo problem që ndodh ata janë të interesuar të dinë gjykimin e Allahut për të. Njerëzit mblidhen rreth atij që jep përgjigje më shpejt sesa rreth të tjerëve, sepse ata ndiejnë nevojën për këtë dije.

Këtë gjë e shohim fare qartë tek shembulli i sahabëve. Profeti a.s. e veçoi secilin prej tyre për një dije si për shembull Ibni Abasin duke thënë: "O Allah, mësoi atij komentin e Kur 'anit", apo te hadithi tjetër: "Nëse Allahu i do të mirën një njeriu, i mëson atij fenë."

Nga të mirat e mësimi të fesë është t'u mësosh të tjerëve atë që të mësoi Allahu. Po kështu dimë se dija e hallallit dhe e haramit është te Muadh bin Xhebel, dija e leximeve të Kur 'anit është te Ubej bin Ka'ab, dija e ndarjes së trashëgimisë është tek Zejd bin Thabit, dija e jurisprudencës dhe gjykimit është tek Ali bin Ebi Talib, etj. Prandaj dhe ndikimi që kishin sahabët te të tjerët që i madh.

Faktori i tretë- mendjemprehtësia. Kjo do të thotë se thirrësi s'është naiv, as i lehtë. Por i përmbajtur dhe gjakftohtë, zotëron një llogjikë të fortë.

Prandaj nëse ka kontradikta dhe mosmarrveshje midis njerëzve, dëgjohet fjala e mendjemprehtit, i cili di si t'i klasifikojë gjërat duke vënë përpara atë çka është më kryesore, i cili di si t'i shfrytëzojë rastet, di si t'i zgjidhë problemet, di si të përshtatet në situata të ndryshme. Për këtë sillet si shembull nga të parët tanë Imami Ebu Hanife El Numan, i cili në një debat me disa ateistë u tha: "Ç'thoni për atë njeri që thotë se anija mund të ngarkohet vetë e të ecë qetësisht midis dallgëve të detit derisa të arrijë në destinacion?"

Thanë: "Ai është i çmendur, sepse anija s'i bën dot këto punë vetëm pa asnjë drejtues."

Atëherë Ebu Hanife tha: "I lartësuar qoftë Allahu, po si mund të mendohet se kjo botë me gjithçka brenda të ketë ardhur vetvetiu?"

Zgjuarsia padyshim është nga faktorët kryesorë që tërheq vëmendjen e njerëzve dhe i bind ata. Prej mendjemprehtësisë dhe mënyrës së komunikimit sa më të mirë me njerëzit, është edhe metoda e krahasimit. Kjo metodë vë në pah anët pozitive dhe negative të diçkaje. Këtë metodë e përdor dhe Kur 'ani kur thotë: " A është njësoj ai që e ngjallëm dhe i dhamë dritë për ta përhapur ndër njerëz, me atë që rri në errësirë e s'del dot prej saj..."

Profeti a.s. ka thënë: "Shembulli i atij që përmend Zotin e tij dhe atij që s'e përmend Atë, është si shembulli i të gjallit me të vdekurin."

Kështu, kur fton njerëzit, vë përpara tyre mirësitë e besimit në dynja dhe Ahiret dhe pasojat e këqija të mosbesimit në dynja dhe Ahiret. Pra metoda e krahasimit i bën njerëzit të mendojnë e të shohin se si përfundojnë gjërat.

Një metodë tjetër është dhe metoda e induksionit, dhe

kjo është një metodë mjaft e përhapur që tregon zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë e atij që e përdor. Po të shohim Kur'anin Fisnik do të hetojmë se kjo metodë përdoret shpesh p.sh. në ajetet e mëposhtme:

"A nuk u krijuan vetë, apo ata janë krijues? Apo krijuan qiejt dhe tokën?...“ deri kur thotë: "A kanë Zot tjetër veç Allahut? Lartësuar qoftë Allahu nga kjo ortakëri". Duke pyetur: "A erdhët vetvetiu apo ishit ju krijuesi, përgjigjja është jo. Pra përse s'e besoni Atë që i krijoi tokën dhe qiejt? " Kështu duke përdorur disa gjëra për të cilat është rënë dakort më parë arrihet në disa përfundime që njerëzit nuk i shohin.

Këtë metodë e ka përdorur dhe Profeti a.s. si p.sh. te ngjarja e atij që i kërkoi leje për të bërë zina. Profeti a.s. i tha: "A kënaqesh ti ta bëjë këtë punë nëna jote? -Tha: Jo. A kënaqesh për motrën tënde, tezen tënde, hallën tënde atj? - Tha: Jo. Atëherë - tha Profeti a.s. - kështu edhe njerëzit s'e duan këtë gjë për nënat, motrat, tezet dhe hallat e tyre." Pas kësaj personi në fjalë doli nga shtëpia e Profetit a.s. duke thënë: "Shkova te Profeti a.s. dhe s'kish gjë më të dashur për mua se zinaja, dola nga ai dhe s'kish gjë më të urreyer për mua se ajo."

Një metodë tjetër është dhe ajo e pranimit të diçkaje si të vërtetë fillimisht, për ta hedhur poshtë pastaj. Kjo gjë bëhet për të mos anashkaluar çështjet e rëndësishme duke u marrë me ato anësore, sepse propaganduesit e së kotës kur debatojnë mundohen me çështje anësore për të mbuluar ato kryesoret.

Kështu p.sh. në historinë e Ibrahimit a.s. në Kur'an me Nemrudin shohim se ai përdori të njëjtin stil:

"A e pe atë që debatoi me Ibrahimin se kush është Zot? Ibrahim i tha: Zoti im jep jetë dhe vdekje. - Ai iu përgjigj: Gjithashtu dhe unë. - Ibrahim i tha: Zoti im e sjell Diellin nga Lindja, sille atë nga Perëndimi po ishe i zoti?! Dhe mosbesimtari u shastis."

Ibrahimi a.s. nuk u ndal të merrej me Nemrudin kur ky i fundit i tha se edhe ai jepte dhe merrte jetë, nuk u ndal të merrej si, qysh e tek, por kaloi te një çështje ku mund ta kapte atë e t'i jepte fund debatit.

Pra, ai që është i zgjuar merret me atë çka është më e rëndësishme dhe e ndihmon në misionin e tij, duke i anashkaluar çështjet më me pak rëndësi, në të cilat mund të humbë dhe t'ia verë fajin pastaj njerëzve pse s'iu përgjigjen atij.

Një metodë tjetër është që gjatë këshillës apo ndonjë fjalimi në publik thirrësi të mos zbulojë apo ekspozojë gabimet apo mëkatet e atyre që këshillon, domethënë këshilla ose të jetë e përgjithshme e pa emra, ose të jepet në fshehtësi në mënyrë që të mos lëndojë, por të shërojë. Kjo ishte metoda dhe stili i Profetit a.s. në shumë fjalime dhe hutbe kur thoshte: "Çfarë kanë disa njerëz që ..." duke mos përmendur emra. Kjo sepse rëndësia e këshillës në përgjithësi për njerëzit qëndron te gjykimi, rregulli apo argumenti që përmban dhe jo tek emrat ndaj të cilëve drejtohet këshilla. Në këtë mënyrë mund të ndreqet

gabimi pa e lënduar atë, ose pa e bërë atë të inatoset e të këmbëngulë në gabimin e tij. Ekspozimi i gabimeve të tjerëve, në përgjithësi nxit ndjenjën e sulmit të çdo njeriu me ose pa të drejtë, ul autoritetin, prandaj ai duhet shmangur.

Dhe metoda e fundit për të cilën do të flasim është përdorimi i butësisë dhe jo i ashpërsisë gjatë këshillës. Butësinë e ka lavdëruar Profeti a.s., këtë e dëshmon dhe hadithi i mëposhtëm:

Hyri një nomad në xhami dhe filloi të bënte ujët e hollë. Shokët e Profetit a.s. deshën t'i flisnin, por Profeti a.s. tha: "Mos e ndërprisni. Pastaj kur mbaroi u tha shokëve të tij dhe jo nomadit: "Hidhini ujë vendit", pastaj shtoi: "Shtëpitë e Zotit nuk lejohet të lëndohen", duke bërë të kuptohet se në to s'kryhen nevojat. Ky është një shembull i qartë se si Profeti a.s. e ka përdorur butësinë.

Ndërsa ashpërsia vjen për disa arsye: nga një ndjenjë artificiale fanatizmi, nga injoranca etj. Kështu disa njerëz kur shohin ndonjë gabim te ndonjë tjetër bërtasin e sulmojnë dhe, në vend që të rregullojnë, prishin. Disa të tjerë sillen butë e me urtësi, por pastaj u vjen dikush që i thotë se s'duhet të sillet kështu, por duhet të ngrënë zërin para së keqes. Kjo vjen ngase ata kanë keqkuptuar butësinë duke kujtuar se ajo do të thotë dobësi.

Faktori i katërt është zemërgjerësia. Kjo për të përfshirë të gjithë njerëzit përreth teje, siç e thotë dhe proverbi: S'i tërheq dot të gjithë njerëzit me pasuri, por me zemërgjerësi. Njerëzit kanë kërkesa të ndryshme ndaj teje, duhet t'i durosh ato, sepse durimi yt, zemërgjerësia jote ndikon te njerëzit. Për këtë kemi me dhjetëra shembuj nga jeta e Profetit a.s. midis tyre hadithi i Enes bin Malik: I shërbeva Profetit a.s. për 10 vjet rresht dhe s'më tha asnjëherë as edhe "uf". Pra, megjithëse natyra e punës së shërbëtorit i përmban urdhërat, kritikën madje dhe përbuzjet, Profeti a.s. nuk i kishte folur ndonjëherë keq Enesit. Kështu duhet të jetë dhe thirrësi, i durueshëm me të tjerët, i mëshirshëm me ta, t'i dhembë zemra kur sheh që ata mëkatojnë, t'i vijë keq kur sheh që refuzojnë të vërtetën, dhe jo të gëzohet e t'i mallkojë duke thënë: "Ata janë mëkatarë, nuk marrin vesh, Zoti i shkatërroftë. Kjo s'është prej sjelljeve të larta, kjo s'është prej sjelljes së Profetëve. Nëse do t'i thithësh njerëzit duhet të vishesh me këto sjellje profetike, me këtë mëshirë madhështore, me këtë dashamirësi të rrallë, të falësh, t'ia hapësh kraharorin tënd njerëzve.

Faktori i pestë është guximi dhe qëndresa. Nënkuptomë këtu guximin e shoqëruar me urtësi, trimërinë në kohë të vështira për njerëzit, si dhe qëndresën përpara fatkeqësive dhe vështirësive kur shumica tërhiqet. Këto cilësi e vënë thirrësin apo këshilluesin në qendër të vëmendjes së njerëzve, i bën ata ta duan, të ndiejnë siguri në praninë e tij.

**Lejla Dervishi**

# DITA E ASHURAS NJË RAST I VOLITSHËM PËR SHFRYTËZIM



Në kushtet e zakonshme, mes kohëve e momenteve të ndryshme nuk ekziston ndonjë dallim apo përparësi. Ndërkaq, disa kohë marrin vlerë pasi janë bërë skenë e ngjarjeve me rëndësi. Pavarësisht se këto kohë mbështeten në shkaqe të ndryshme, sërish përbëjnë raste me vlerë që kanë një funksion të përbashkët në rifreskimin e rigjallërimin moral dhe shpirtëror të individit. Nuk duhet çuar nëpër mend se një ngjarje e caktuar i përket vetëm ditës kur ka ndodhur për herë të parë, ndërsa, më pas, ditës në fjalë nuk i mbetet asgjë për t'u përmendur. Edhe pse ngjarja nuk përsëritet, vlerat dhe bukuritë që ajo mbart rishfaqen dhe marrin një tjetër dimension në atë ditë të caktuar kalendarike.

E tillë është edhe dita e ashures, që përkon me një sërë ngjarjesh të shënuara në historinë e njerëzimit. Në lidhje me këtë, imam Gazali thotë: "Për epërsitë e kësaj dite na kanë ardhur shumë informacione. Sipas tyre, në këtë ditë është pranuar pendesa e Hz. Adem, është ndaluar në malin Xhud anija e Hz. Nuhut, ka lindur dhe ka dalë nga flakët e zjarrit pa u djegur Hz. Ibrahim, është shëruar nga sëmundja e gjatë Hz. Ejubi, ka shpëtuar nga barku i peshkut Hz. Junusi, është ngjitur në qiell Hz. Isai. Po në këtë ditë ka rënë dëshmor në vendin e Qerbelasë nipi i dashur i profetit, Hysejri r.a."<sup>1</sup>

Fjala "ashura" vjen nga arabishtja dhe rrjedh nga rrënja "ashr", që në gjuhën arabe do të thotë dhjetë. Ashura është dita e dhjetë e muajit Muharrem, sipas kalendarit hënor. Sipas një transmetimi të Abdullah bin Abasit, kur profeti Muhamed a.s. erdhi në Medine, vuri re se hebrenjtë mbanin agjërim ditën e ashuras dhe pyeti për shkakun. Ata iu përgjigjën: "Kjo është një ditë e madhe. Në këtë ditë Allahu e shpëtoi Musain dhe popullin e tij nga dhuna e Faraonit. Si falënderim për këtë, profeti Musa e agjëroi. Edhe ne për respekt e agjërojmë". I dërguari i Allahut a.s. u shpreh: "Ne e nderojmë më shumë se ju profetin Musa a.s.". Duke mbajtur edhe vetë agjërim urdhëroi popullin e tij të agjërojë ditën e ashuras<sup>2</sup>.

Pasi u bë obligim agjërimi i Ramazanit, Hz. Muhamedi a.s. sollí një tjetër koncept për këtë temë duke thënë: "Pa dyshim që

1. Imam Gazali, Mukashefetu'l-Kulub.  
2. Muslimi.

ashura është njëra nga ditët e Allahut. Ai që dëshiron të agjërojë dhe kush nuk dëshiron, le të mos ta agjërojë"<sup>3</sup>. Agjërimi i ashuras është sunet, por, Profeti ynë i nderuar na këshillon që së bashku me ditën e dhjetë të Muharremit, të agjërohet edhe dita e nëntë ose e njëmbëdhjetë, ose të tria pa shképutje. I dërguari i Allahut a.s. në një thënie të tij thotë: "Dallohuni nga tradita e hebrenjve, duke agjëruar një ditë para ose ditën pasuese të ashuras"<sup>4</sup>, ndërsa në vitin e fundit të jetës së tij mësohet të jetë shprehur: "Nëse jetoj edhe vitin që vjen, do të agjëroj ditën e nëntë dhe të dhjetë"<sup>5</sup>.

Katade transmeton se sahabët e kanë pyetur Profetin a.s. për agjërimin e ashuras dhe ai u ka thënë: "Agjërimi i ditës së ashuras i shlyen gjynahet e vitit të kaluar"<sup>6</sup>. Ndërsa Xhabiri transmeton se i dërguari i Allahut ka thënë: "Kush është bujar me veten dhe me familjen e tij ditën e ashuras, Allahu do të jetë bujar me të gjithë vitin"<sup>7</sup>.

Dijetarët e kanë përmendur agjërimin e ditës së ashuras në tre mënyra:

- 1- Agjërimi i tre ditëve 9, 10 dhe 11 të muajit Muharrem.
- 2- Agjërimi në ditën e 9 dhe të 10 të këtij muaji.
- 3- Agjërimi vetëm në ditën e 10 të muajit Muharrem.

Ashura është vërtet një rast i volitshëm për besimtarët myslimanë, që t'u falen gjynahet dhe të hedhin hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit. Ajo është një mundësi e vyer për njeriun, sepse gjen rastin për t'iu lutur e për ta përmendur Zotin, për mëshirë dhe paqe për Profetin, mendon rreth të metave e gabimeve, si dhe pendohet për mëkatet që i kanë trazuar qetësinë shpirtërore.

Duke marrë si shkas këtë ditë të shënuar, le të kujtojmë edhe një herë fqinjën e të afërmin, le të frenojmë egon tonë duke agjëruar, të pajtohemi me atë që nuk flasim dhe të kujtojmë devizën islame: "Të gjithë myslimanët janë vëllezër".

3. Buhariu, Muslimi.  
4. Buhariu.  
5. Muslimi, Ebu Daudi.  
6. Muslimi.  
7. Bejhaku.

# Gjeografia dhe Kur'ani

Kur'ani është një libër i shenjtë, i cili pasqyron udhëzimet e Allahut (Zotit) për njerëzimin nëpërmjet të dërguarit të Tij të fundit, Muhamedit a.s. Gjeografia është një shkencë që studion Tokën dhe i ka fillimet e veta që në lashtësi. Midis Kur'anit dhe Gjeografisë ka një lidhje mjaft të ngushtë, e cila pasqyrohet në shkrimet e shenjta, të cilat nuk mungojnë edhe në literaturat e kësaj shkence.

Kur'ani ka zbritur në gjysmën e parë të shekullit të VII pas erës sonë dhe jep fakte konkrete dhe të sakta, në të cilat shkencë e gjeografisë, dhe ato që kanë lidhje të ngushtë me to, i kanë verifikuar nëpërmjet teorive dhe aparaturave të ndërtuara për këtë qëllim. Fillimisht shumë shkencëtarët të saj kohe dhe më pas, pushtetarë dhe udhëheqës të shteteve të ndryshme të Mesjetës apo dhe njerëz të zakonshëm i përbuznin



shkrimet që ndodheshin në Kur'an dhe i quanin si trillimet e Muhamedit a.s. Por zhvillimi i shkencës në vendet myslimane dhe dhënia e mendimeve e teorive shkencore në Evropë në kundërshtim me dogmat kishtarë, bëri që të verifikohen një e nga një shkrimet që ndodheshin në Kur'an. Këtu nuk bëjnë përjashtim edhe shkrimet e karakterit gjeografik, duke filluar që nga modeli heliocentrik i Kopernikut dhe më pas me ligjin e gravitetit të Njutonit, ligjin e Relativitetit të Ajnshtajnit apo edhe zbulimin e fakteve shkencore të sakta mbi formimin e fenomeneve meteorologjike, lëvizjeve të pllakave tektonike etj.

Gjeografia fizike e përgjithshme si degë e Gjeografisë së Përgjithshme, që nga koha parahistorike është marrë me studimin e mënyrës së krijimit të universit, objekteve të cilat ndodhen në të (galaktikat, yjet, planetët, asteroidet e kometat), rrotullimin e tyre, e deri te dhënia e hipotezave rreth shkatërrimit të universit bashkë me objektet hapësinore. Kjo degë e Gjeografisë, gjithashtu merret me përshkrimin dhe studimin e Tokës, duke i përfshirë të gjitha sferat e saj: Atmosferën, Litosferën, Biosferën dhe Hidrosferën. Ajo merret edhe me orientimin në natyrë (orientimi me anë të yjeve dhe yjësiive, Diellit dhe Hënës), si dhe llogaritjen e kohës sipas kalendarit (kalendarit diellor dhe atij hënor).

Kur'ani ka shumë ajete që na tregojnë për veçoritë shkencore – gjeografike, të cilat vërtetojnë se Kur'ani është me të vërtetë libër i shenjtë. Njëra prej shumë veçorive është fakti se një numër i konsiderueshëm i këtyre fakteve shkencore të lartpërmendura, njeriu i ka zbuluar vetëm me ndihmën e teknologjisë së shekullit XX, të cilat janë shpallur në Kur'an 1400 vjet më parë. Këto fakte shkencore, në kohën e Muhamedit a.s. as që mund të perceptoheshin apo imagjinoheshin. Këto fakte shkencore e vërtetojnë edhe më tepër prejardhjen hyjnore të Kur'anit. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

"A nuk shikojnë ata me vëmendje nga qielli se si mbi ta e kemi ndërtuar atë, e kemi zbuluar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti? Edhe tokën se si e kemi shtrirë e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. Dëshmi të dukshme dhe përkujtuuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen. Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra që korren. Dhe rritëm trungje të gjata hurmash me fruta të paluar njëri mbi tjetrin." (Kaf, 6-10)

Zoti xh.sh. i fton njerëzit të studiojnë dhe të reflektojnë rreth qiejve, tokës, maleve, yjeve, bimëve, farave, kafshëve, ndryshimeve të natës me ditën, krijimit të njeriut, shiun dhe shumë gjëra të tjera të krijuara. Duke i eksploruar këto fakte, njeriu arrin ta njohë aftësinë artistike të krijimtarisë së Zotit. Më këto krijime njeriu arrin ta njohë Krijuesin e tij, i Cili krijoi të gjithë universin dhe çdo gjë që ndodhet në të nga asgjëja. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

"Është fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e Tokës, (në të gjitha këto), ka argumente për një popull që ka mend." (Bekare, 164)

Edhe pse në Kur'an gjejmë shumë fakte shkencore, të cilat janë zbuluar në mënyrë të plotë më ndihmën e teknologjisë bashkëkohore, Kur'ani nuk është një libër shkencor e as që mund të pretendojmë një gjë të tillë. Qëllimi i shpalljes së tij është udhëzimi i njerëzve drejt së vërtetës dhe jo shtjellimi i fakteve shkencore apo shpjegimi i dukurive natyrore.

Muhamedi a.s. nuk ishte gjeograf, që ta studionte këtë shkencë dhe t'i shkruante këto teori kaq të sakta dhe precize para 1400 viteve, ku shkencëtarët e asaj kohe as që mund t'i paramendonin, e jo më t'i studionin dhe të shkruanin për to. Por edhe nëse supozojmë se Muhamedi a.s. ishte shkencëtari më i mirë i kohës, ai nuk do të kishte mundësi t'i dinte dhe t'i studionte këto fakte që gjenden në Kur'an, për arsye se teknologjia e asaj kohe nuk do t'ia kishte mundësuar këtë gjë. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

"Që pranojnë të dërguarin (Muhamedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon)..." (Araf, 157)

Zoti xh.sh. me anë të Kur'anit nuk iu drejtohet vetëm arabëve, por të gjithë njerëzimit pa dallim race, ngjyre, moshe, gjinie, apo niveli arsimor. Gjithashtu Zoti xh.sh. e dërgoi Muhamedin a.s. pejgamber për mbarë njerëzimin:

"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed) veçse si mëshirë për botët." (Enbija, 107)

Përveç kësaj, Kur'ani ka shumë fakte shkencore, jo vetëm të shkencës së Gjeografisë, por edhe shkencave të tjera si: Biologjisë, Mjekësisë, Astronomisë, Fizikës etj., disa prej tyre janë zbuluar vetëm në shekullin e kaluar. Këto zbulime në kohën e Muhamedit a.s. as që ishin menduar se mund të ekzistojnë, si dhe nuk kishin mundësi as që të zbulohen me teknikën e asaj kohe. Me përputhjen e plotë të të dhënave shkencore në fushën gjeografike dhe jo vetëm, të zbuluara në 2-3 shekujt e fundit, me shkrimet e shenjtë, dëshmohej se këto nuk janë trillime të të dërguarit të Allahut, por fjalët e të Madhërishmit Fuqplotë, i Cili ka formuar gjithçka që ndodhet në Tokë dhe në hapësirën e pafund të gjithësisë. Për këto fakte shkencore Zoti xh.sh. na tregon në Kur'an ku thotë:

"Thuaj: 'Më tregoni, nëse ai (Kur'ani) është prej Allahut, e ju e mohuat atë, kush është më i humbur se ai që është në kundërshtim të fortë?' Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" (Fussilet, 52-53).

# Profeti

që angazhoi në rrugën e tij  
çdo zemër besimtari

Profeti Muhamed a.s. personaliteti më i madh, dhe figura më e dashur për besimtarët myslimanë, nuk na shfaqet në trajtën e një mbinjeriu. Përkundrazi, gjithçka tek Ai, është sa e lartë aq edhe integralisht humane, një dukuri e tërësishme e cila gjendet e trupëzuar në vetë personalitetin e Profetit a.s.

Brenda tij shkëlqeu mahnitshëm bukuria e shpirtit, shkalla më e lartë e fisnikërisë të një karakteri të përsosur, dashuria gjithëpërfshirëse që rrëmbeu ndjenjat, imagjinatën dhe inteligjencën e myslimanit, çka përbejnë një kombinim të realitetit tokësor me idealet më të larta morale dhe shpirtërore.

Besimtarët myslimanë sa herë që përmendin emrin e profetit Muhamed a.s. derdhin lumenj bekimesh për të; invokacion ky, që derivon drejtpërsëdrejti si një arketip qiellor, pasi siç citohet edhe në Kuranin e shenjtë:

“Vërtetë, edhe vetë Allahu së bashku me engjëjt e tij e mbulojnë Profetin me bekimet e tyre.” (33:56)

Profeti a.s. manifestoi deri në perfeksion virtytet më të larta të qenieve njerëzore derisa çdo veprim i tij u bë objekt shqyrtimi i kujdesshëm, veprime të cilat u kodifikuan, e ku çdo thënie e tij u memorizua në kujtesën e bashkëkohësve, që më vonë u shkruan dhe për breza të tërë u bënë dhe vazhdojnë të jenë deri në fund burim i dytë dijesh pas Kur’anit.

Për këtë arsye personaliteti dhe vepra e tij qëndrojnë si një ideal i përgjeshëm i trupëzuar brenda një qenie njerëzore, një ideal i cili synohet për t’u arritur nga çdo besimtar mysliman.

Në lidhje me sa u tha, Kur’ani citon:

“Vërtetë shembullin më të përkryer ju e patët tek i dërguari i Allahut ” (33:21)

Gjerësia, thellësia e jashtëzakonshme kuptimore që ka rrethuar gjithë jetën e Profetit a.s. mbi tokë, siguron për besimtarin një rend pa fund precedentësh të cilët mund të merren si etalonë shembullorë, normash e vlerash që mund mbulojnë praktikisht të gjitha dimensionet njerëzore të njeriut në këtë jetë. Kjo sepse Profeti a.s. ka qenë njëherësh, mendimtar soditës, udhëheqës i masave dhe asket, thellësisht i epur drejt botës tjetër, ndërkohë që ishte bërë tashmë tepër i suksesshëm mbi tokë.

Ai kishte përjetuar varfërinë dhe vetminë e jetimit, bari në fillim dhe më vonë tregtar. Ai provoi jetën e të syrgjynosurit e më vonë gëzimet dhe hidhërimet e jetës bashkëshortore. Ai ishte njëkohësisht udhëheqës ushtarak, gjykatës religjioz dhe burrë shteti, themelues dhe drejtues i të parit shtet islam në botë. Ai

ishte fara e shëndetshme e një perandorie të ardhshme botërore. Dhe e gjitha kjo veprimtari kaq intensive pa harruar për asnjë çast të vetëm siç dëshmohet në Kuran, t’i kushtojë Allahut devocion përmes adhurimeve të veta.

Kështu ai përbën një model të përkryer jo vetëm në përputhje me nocionin religjion ashtu siç konceptohet normalisht sot në botë, por edhe në tërësinë e vetë ekzistencës së racës njerëzore.

Për myslimanin jeta nuk mund të ndahet në dy pjesë, në atë që i përket religjionit, dhe tjetrës që i përket sferës laike. Përkundrazi, të dyja këto gjysmë sfera përbëjnë një të tërë e të pandarë që është vetë ekzistenca e cila më pas, asimilohet tërësisht brenda idealeve profetike.

Sigurisht që nuk është e thënë që çdo mysliman të ketë prirjen për t’u bërë gjykatës ose udhëheqës, por nga ana tjetër është e detyrueshme që secili besimtar pavarësisht nga rrethanat të jetë i ndershëm e të jetojë një jetë të virtutshme në përputhje me ligjet e fesë.

Në qoftë se dy elementët universalë, besimi tek Allahu, virtyti dhe puna e ndershme do realizohen në mënyrë perfekte nga ana e besimtarit mysliman, atëherë ai duhet të jetë i sigurt se është në udhën e drejtë të vetë Profetit.

Po kështu manifestimi te besimtari i vlerave të larta morale si të qenët i drejtë, bujaria, mëshira, sinqeriteti, dashuria për hir të Zotit etj., përbëjnë tipare themelore të cilat afrojnë gjithnjë e më shumë besimtarin me idealet profetike.

Gjatë përvojave të imitimit të vlerave shpirtërore të Profetit a.s. besimtari do të gjejë patjetër rrugën e tij të shpëtimit shpirtëror.

Është e nevojshme për të shënuar këtu se koncepti mbi imitimin e Profetit a.s. nuk qëndron në purifikimin shpirtëror nëpërmjet empatisë, vuajtjeve te Profetit, por nëpërmjet pjesëmarrjes direkt në ekuilibrat e qëndrueshëm shpirtëror, kërkesë kjo që përbën si konditën ashtu edhe konsekuencat që rrjedhin prej saj, çka do të thotë që ekuilibrat tokësorë për hir të ngjitjes qiellore, përbëjnë aksionin më virtuoz që realizon besimtari mysliman.

Që të mund të bëjmë një vlerësim qoftë edhe të përgjithshëm të lidhjeve që ekzistojnë ndërmjet besimtarëve myslimanë dhe profetit Muhamed a.s., si dhe të mund të hedhim pak më larg vështrimin tonë për të parë më qartë madhështinë e natyrës së tij, le t’i drejtohemi Kur’anit të Shenjtë dhe historisë islame.

Mbase nuk është nevoja të shtojmë që, kjo mënyrë arsyetimi disi eliptike, e errëson faktin se madhështia e tij humane u lartësua në

dimensione kozmike në saj të hireve qiellore që e rrethonin atë gjatë kohës së marrjes nga ana e tij të mesazheve kur'anore.

Prej këtej del se për të dashur Profetin a.s. duhet të duam edhe veshjen "materiale" njerëzore të tij që vjen nga refleksionet kuranore.

Kjo do të thotë që duhet të duam atë që është në konformitet të plotë me të vërtetat absolute që reflektohen në faqet e Librit të Shenjtë.

Duke parë problemin në këtë prizëm ne do të vlerësonim akoma më mirë e më drejt atë që iu urdhërua Profetit për t'ia proklamuar njerëzimit.

Në mbështetje të dashurisë ndaj Allahut myslimanit i pohohet se do të bëhet i dashuri i Tij në qoftë se do të ndiqte udhën e Profetit (a.s.). Kjo për arsye se Muhamedi a.s. ishte habibullah (i dashuri) i Allahut xh.sh., dhe shkuarja pas tij besnikërisht dhe me gjithë zemër e bëjnë besimtarin akoma më të dashur ndaj Krijuesit.

Kështu, ai që bekon me lutje Profetin do të shpërblehet me dhjetëfishin e bekimeve nga Allahu i madhëruar.

Allahu e shpërblen dashurinë e myslimanit ndaj Profetit duke zbritur mbi ta (dashuruesit) bekimet e veta.

Ajo çfarë mund të themi pas kësaj që parashtruam deri këtu, është se, të sigurosh afërsi me Allahun duhet të krijosh këtë afërsi së pari me Profetin a.s.

Në Kur'an është shkruar se:

"...vërtetë profeti u qëndron më pranë besimtarëve nga ç'i qëndrojnë ata vetes së tyre..." (33:6)

Kjo e vërtetë nuk do mundej të shpjegohej plotësisht për shkak të qëndrimit jashtë konceptit kohë. Sidoqoftë afërsia ndërmjet Profetit dhe besimtarëve myslimanë kapërcen çdo kufi kohor, sepse jeta, vepra dhe virtytet e tija, intimiteti me të është vulosur thellë në zemrën e besimtarit mysliman, ndaj askush prej nesh nuk e imagjionon Muhamedin a.s. si një subjekt që ka jetuar në një epokë tjetër historike.

Lidhjet e tij me kombin islam, janë lidhje shpirtërore. Ato përbëjnë një receptor të përkryer të hapur për t'u ripërtërirë nëpërmjet besimit, praktikimit të virtyeteve devocioneve të sinqerta ndaj Allahut të madhëruar dhe të dërguarit te Tij.

Profeti konstitui në të vërtetë trupëzimin e këtij receptiviteti të kulluar të shpirtave në lidhjet e tyre me Allahun.

Për vlerësimet dhe respektin e thellë të shprehur nga besimtarët myslimanë për profetin Muhamed a.s., njerëz që nuk e njohin mirë besimin islam apo edhe njerëz të besimeve të tjera do të bënin pyetjen:

"Si mund të shpjegohet ky devocion i jashtëzakonshëm i transmetuar nga njëra epokë në tjetrën e brez pas brezi, dhe që nga ana e jashtme shprehet nëpërmjet lutjesh nga më sublimet, himneve dhe poemave që e lartësojnë Profetin nga njëri cep i botës myslimane në tjetrën deri në adhurim?"

Nga ana tjetër përpara Allahut njerëzit janë të barabartë dhe askush nuk ka nevojë që përt'u afruar te Krijuesi të përdorin ndërmjetës. Dhe mendimi vazhdon të mbetet i mjegullt kur pohojmë se është po aq e vërtetë se Kur'ani i ngarkon besimtarët myslimanë me detyrimin për të ndjekur Profetin në rrugën e tij. Po kështu e gjithë trashëgimia e tij profetike përbën një burim themelor të ligjit islam që i nënshtrohet autoritetit të vetë Kur'anit.

E megjithatë, për sa u trajtua më sipër, përbën pjesërisht devocionin ndaj Profetit. Kjo ngaqë është tjetër gjë t'i nënshtrohesh një rregulli të jashtëm dhe krejt tjetër ta adhurosh rregullin në kuptimin e përqasjes së tij brenda kontekstit human.

Ligji nuk mund të bëjë më shumë se sa të urdhërojë bindje të vullneteve, ndërsa Profeti angazhon çdo zemër besimtari në rrugën e tij.

Përgjigjen për të gjitha këto e gjejmë në Kur'anin e Shenjtë.

Tashmë është fakt i njohur që besimi islam mbështetet rigorozisht mbi adhurimin ndaj Allahut të madhëruar, nocion i cili konceptohet si një "Transhendent Absolut".

Nga ana tjetër Muhamedi a.s. nuk ishte tjetër veçse një qenie njerëzore para së të ishte i dërguari i Allahut. Si qenie njerëzore që ishte Profeti a.s. nuk mund të konsiderohej në universin shpirtëror të botës islame si një objekt kulti që mund të adhurohej. Këtë na dëshmon një nga versetet e para të Kur'anit të Shenjtë.

"...nuk ka zot tjetër përpos Allahut ...". Kjo na bën të

qartë se përveç Allahut nuk mund të ketë adhurim tjetër nga ana jonë.

Islami nuk fokuson transfigurimin e Allahut të madhëruar në vetë figurën e Profetit a.s.

Dukuritë dhe paradokset që mund të vërehen nga një vrojtues i jashtëm i pa informuar mirë në vlerësimet që bëhen për profetin Muhamed a.s., një studiues i kujdesshëm mund t'i arrijë vetëm nëpërmjet zhvendosjes së përqendrimit të tij mediativ nga dimensionet e jashtme të veprimit, drejt dimensioneve të brendshme të formatizuara sipas karakterit të vetë Profetit a.s.

Madhështia e këtij konceptimi është aq marramendës dhe vetëndriçues sa që nuk mund të mos ngjallë respekt të zemrat e vrojtuesve të paanshëm, të cilët hulumtojnë përmes veprës dhe jetës së Profetit a.s.

Të kesh besim ndaj Profetit nuk mjafton të besosh vetëm në mesazhin ndaj sinqeritetit që përcillet përmes tij, por ai ngërthen në vetvete edhe një orientim moral dhe psikologjik përmes veprës dhe personit të tij, jo për ta konsideruar atë si "shpëtimtar" sepse ditën e gjyqimit gjithkush "... do japë llogari për mëkatet e tija, dhe se institucioni i shpërblimit apo i ndëshkimit sipas veprave që njeriu ka kryer në jetë përbën mjetin më racional për ta mbajtur atë sa më larg së keqes dhe mëkatit, dhe në fund besojmë se ditën e gjyqimit, vetëm Allahu me mëshirën e tij si e vetmja instance e lartë hyjnore, ka tagër për të falur mëkatet.

Por i dërguari i Allahut të madhëruar është ai që u shtien ndërmend besimtarëve myslimanë ekzistencën e madhërishtme të Allahut, detyrat dhe kushtet e lutjes ndaj Tij.

"... të dërguam ty Muhamed, si dëshmitar përgëzues dhe qortues..." është shkruar në Kur'anin e Shenjtë.

Mjeti kryesor i kthimit pranë Allahut dhe i përfitimt të kënaqësisë të të qenët në krah të tij është beteja shpirtërore që njeriu zhvillon brenda vetes për të luftuar të keqen dhe për të triumfuar e mira. Është ky imperativ i të përkushtuarit nëpërmjet adhurimeve kushtuar Allahut, edhe nderimi më i madh që i bëjmë Profetit a.s.

Në këtë mënyrë rikthimi shpirtëror pranë Krijuesit fillon me nevojën e ndërgjegjësimit për të

dashur Profetin a.s. Akti i dashurisë ndaj Allahut, ngërthen në vetvete njëkohësisht edhe respektin ndaj Profetit a.s. Ky respekt nuk manifeston një besim të verbër, por një siguri absolute. Bash për këtë Profeti a.s. ka konfirmuar:

"Askush nuk e beson Allahun, në qoftë se nuk beson në mua."

Profeti Muhamed a.s. është njëherësh burim frymëzimi mistik, model i sjelljeve të përkryera, si dhe një kombinim i gjithçkaje tokësore me atë qiellore.

Kur'ani i ngarkon të gjithë besimtarët për të ndjekur rrugën e Profetit a.s. dhe të dëshmojnë bindje ndaj Tij.

Praktika, sjelljet, veprimet dhe fjala e Tij përbëjnë një burim themelor të ligjit islam pas Kur'anit.

E gjithë trashëgimia profetike është në korrelacion të plotë me të vërtetat kuranore, dhe i nënshtrohen vetëm autoritetit të tij (Kur'anit).

Është detyrë e besimtarëve myslimanë, e pjesës elitare myslimane në radhë të parë për të hulumtuar mbi të vërtetat e mesazhit qiellor dhe kulturën profetike.

Objekt hulumtimesh për ne është edhe vetë familja e Profetit a.s.

Janë ata që kanë shpjeguar Kur'anin e shenjtë, dhe që janë burim i dytë dijes pas Kur'anit. Ata janë modeli shkencor i ndërtimit të shkollave juridike islame.

Kur iu drejtohem dijeve islame bindemi se me të vërtetë familja e Profetit a.s. është një minierë dijes që i është referuar i gjithë kombi islam.

Ata kanë qenë mbrojtësit e së vërtetës, dhe atyre nuk u munguan dijet, e nuk u kursyen për t'ia mësuar ato të tjerëve.

Që të mund të shohim më qartë perspektivat e së ardhmes tonë, duhet të studiojmë mirë dhe të njohim programet që ato ndërtuan dhe zbatuan për formimin e një modeli të shëndoshë islam.

Të ecim në rrugën që ata ndoqën, dhe t'i marrim shembull udhërrëfimet e tyre dhe të profetit Muhamed a.s.

**nga Halit Muharremi**

# LARTËSIMI DHE PËRHAPJA E QYTETËRIMIT ISLAM

Para se të meditojmë përmbi të ardhmen e njerëzimit në këtë mijëvjeçar të ri, do të ishte me vlerë të shqyrtonim mijëvjeçarin që sapo përfundoi, dhe veçantitë e tij të natyrshme, duke qenë i mbushur plot me ngjarje të mëdha. Një mijë vjetët e fundit dëshmuar rënien dhe ngritjen e qytetërimeve, luftëra dhe kundërshti fetare apo kombëtare e racore, grupime dhe shpërndarje a gjyftime popujsh a shtetesh, dhe një këmbëngulje në rritje për të drejta njerëzore, paralel me rritjen e mizorisë dhe dhunimit.

Islami u shfaq në një stad të historisë, në një kohë të vështruar si më të errëtat e historisë njerëzore. Një kohë kur fetë e mëparshme kishin dalë nga udha e profetëve, dhe kishin përfunduar nga fe, në kulte. Në këtë periudhë të historisë njerëzore, lindi dhe mori shpalljen hyjnore profeti Muhamed a.s.

Të ndezur nga afshi i përhapjes së thirrjes islame për në Zotin Një, e për një botë drejtësie, barazie e vëllazërimi, ndjekësit e profetit Muhamed a.s. arritën që më se një shekull prej vdekjes së tij, ta shpalosin flamurin e Islamit përmes Afrikës Veriore e Spanjës, drejt Pirenejve në Francë e mes Persisë, Indisë e Turkistanit, deri në kufijtë e Kinës.

Profesor Philip Hitti me të drejtë nënvizon se në 100 vitet pas ndërrimit jetë të Profetit a.s., pushteti i mëkëmbësve të tij, kishte marrë formën e një shteti botëror, të shtrirë nga Kina në Francë.

Dinastia e madhe emevite, me bazë në Damask (661-750), dhe më e madhja se ajo, dinastia abasite, në Bagdad (750-1258), dhe të tjera dinasti të përmendura, si ajo e fatimidëve në Kajro apo sërish e emevite në Kordovë, janë të rëndësishme në kapitullin e historisë islame. Myslimanët

sollën me to, një qytetërim të freskët, një mënyrë tjetër të të vështruarit dhe të jetuarit të jetës; ata erdhën në skenën botërore për të qenë personazhe kryesore.

Me qëllim që të shpjegojnë përhapjen e furishme e fenomenale të Islamit në kohët e para të tij, kritikët shpesh kanë sugjeruar se myslimanët kanë vringëlluar shpatat për të hapur fenë e tyre revolucionare. Shkruan të ndryshëm perëndimorë e kanë përshkruar luftëtarin mysliman me shpatën në një dorë dhe me Kur'anin në tjetrën. Por ama çdokush e di mirë se shpata nuk është frytdhënëse si një mënyrë për të futur njerëzit në fe.

Duhet parë për shkaqe të tjera. Duhet parë në bukurinë, në thjeshtësinë dhe barazinë që rrezaton Islami, i cili ofronte një baraspeshë midis çështjeve të botës e atyre të fesë, duke e tërhequr kështu natyrshëm njerëzinë kudo.

Will Durant, një i krishterë i devotshëm dhe një kritik i njohur i Islamit, megjithatë shkruan:

"Në Kur'an nuk ka vetëm rregulla për sjelljet e mira dhe pastërtinë, martesën e ndarjen, e trajtimin e fëmijëve, skllëvërve e kafshëve, por gjithashtu për tregtinë e politikën, interesin dhe borxhin, marrëveshjet dhe trashëgiminë, industrinë dhe financat, krimin dhe ndëshkimin, luftën e paqen. Muhamedi a.s. i kërcënoi me ferrin, tregtarët mashtrues e të pandershëm, denoncoi spekulatorët e monopolistët të cilët grumbullonin mallra për t'i shitur më pas më shtrenjtë, urdhëroi punëdhënësit t'i japë punëtorit shpërblyimin para se t'i thahet djersa. Ai ndaloi të jepet a të merret interesi (fajdeja). Asnjë reformator më mirë se ai nuk u vuri taksat të pasurve për të ndihmuar të varfrit. Dallimi në racë apo sërë, kaq i fuqishëm midis fiseve të kohës, u



zvogëlua prej besimit të njëjtë; siç edhe ai tha: 'Edhe nëse një skllav i zi caktohet t'ju udhëheqë, dëgjojeni e bindjuni atij...'

Veç kësaj, ndikim pati edhe fakti që dijetarët e Islamit iu dhanë me mish e shpirt grumbullimit të thesareve të vjetra të dijeve dhe arteve.

Veprimtaria mendore e myslimanëve të hershëm, përgjithësisht klasifikohet në dy: në atë çka ishte fillesë e arabëve si gjuhësia, letërsia, teologjia, ligjshmëria e historia, si edhe atë çka ishte përftesë prej takimeve me popujt e tjerë, si filozofia, matematika, astronomia, mjekësia, shkencat natyrore e gjeografia etj. Nevoja e mbajtjes në këmbë të strukturës madhore të një rendi politik e shoqëror në shtetin islam, në mënyrë që kjo strukturë të buronte e të mbështetej në Kur'anin e shenjtë dhe në shembullin e Profetit, bëri që fillimisht dijetarët myslimanë të shkëlqenin në grupin e parë të shkencave.

Myslmanët e nisën aventurën e tyre intelektuale me përkthimet voluminoze nga persishtja, sanskritishtja, siriakishtja e greqishtja. Gjatë fazës së përkthimeve (750-850), u arrit një situatë e tillë, gjatë së cilës, bota myslimane të kishte në duart e saj kryeveprat e lashtësisë prej kulturave të ndryshme, dhe mundësinë për t'i përsosur më tej këto kryevepra.

Kështu, duke filluar nga gjysma e shekullit të nëntë, myslimanët filluan një epokë ndihmesash vetjake në shkencën, duke kapërcyer kështu fazën e përkthimeve.

Në pak shekuj ata prodhuan disa prej shkencëtarëve, filozofëve, historianëve dhe juristëve më të mirë të njerëzimit. Në këtë periudhë, tokat e tyre ishin qendra të qytetërimit dhe mendjendriçimit. Përparimi, zhvillimi dhe

animi i përgjithshëm për nga toleranca, ishin në një kontrast të thellë me prapambetjen, varfërinë dhe fanatizmin që mbanin shtrënguar Evropën e kohës.

Historiani Stanley Lane-Poole, shkruan: "... Tarik Mauri (Tarik bin Zijad), ia shtoi tokën e Vizigotëve (Spanjën) katalogut të pasur të mbretërive të rëna në duart e myslimanëve. Për më se tetë shekuj, nën prijësit e saj myslimanë, Spanja i dha gjithë Evropës një shembull të shkëlqyer të një shteti të qytetëruar. Aty, krahinat pjellore u kthyen dyfish prodhimtare prej aftësive teknike të zotëruesve të saj.

Arti, letërsia dhe shkencën përparuan si jo tjetërkund në Evropë. Studentë nga Franca dhe Gjermania dhe Anglia vërshonin për të pirë prej burimeve të dijes të cilat rridhnin prej qyteteve të myslimanëve. Kirurgët e mjekët e Andaluzisë ishin pararoja e shkencës së kohës; gratë mbështeteshin për të studiuar seriozisht.

Matematika, astronomia, botanika, historia filozofia e jurisprudencën arritën stadi mjeshtëror në Spanjë. Metoda shkencore e irrigimit të ujërave, artet e fortifikimit dhe të anije-ndërtimit, prodhimet më të rafinuara të cohës, veglat e gdhendësve dhe poçarëve u përmirësuan në këtë kohë nga banorët e Spanjës.

Në praktikën luftarake jo më pak se në artet e paqes, ata qëndruan mbi të tjerët për një kohë të gjatë. Gjithë çka e bën një mbretëri të madhe dhe të përparuar, gjithë çka çon drejt përsosjeve dhe qytetërimit, mund të gjendej në Spanjën myslimane."

**Dr. Mozemil Haque**

# Torturat që hoqi i Dërguari ynë Fisnik në Taif

Uruete bin Zubejri (radijallahu anhu) transmeton: “Kur vdiq Ebu Talibi, edhe vuajtjet e shqetësimet e të Dërguarit të Allahut u shtuan edhe më shumë. Me shpresën se do t’i vinin në ndihmë e do t’i bëheshin krah, ai shkoi pranë fisit të Thakifëve në Taif. Atje gjeti prijësit e fisit të Thakifëve, Abdi Jalejlin, Hubejbin dhe Mesudin. Ai iu ankua atyre për vuajtjet dhe padrejtësitë që kurejshët u kishin bërë, si atij vetë, ashtu edhe shokëve të tij, duke u kërkuar sakaq që t’u vinin në ndihmë

dhe t’i mbështesnin. Njëri nga këta tre vëllezër u hodh e tha:

- “Nëse Allahu të ka dërguar ty me një detyrë, atëherë unë e vjedh mbulesën e Qabes!”

- “Këtej e tutje unë nuk do të flas më, as edhe një fjalë të vetme, me ty, sepse, nëse ti je një profet, atëherë ty nuk ta lejon detyra që të flasësh me një njeri të thjeshtë e të zakonshëm si unë!”, – tha i dyti.

Kurse i treti e priti me fjalët:



- "Allahu, nuk gjeti dikë tjetër, përveç teje, për të dërguar? Kaq i dobët është Ai, sa që nuk gjeti dot dikë më të mirë se ty?"

Këta njerëz nisën t'i përhapnin edhe në mesin e thakifasve të tjerë ato fjalë që u kishte thënë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kështu që nuk mjaftuan vetëm ata, por u mblohdën edhe pjesëtarët e tjerë të familjeve, që erdhën për t'u tallur me të Dërguarin e Allahut. Morën gurë nëpër duar dhe u bënë dy radhë të gjata nëpër të dyja anët e rrugës. Gurët godisnin trupin e bekuar të Resulullahut dhe ia plagosën gjunjët, megjithatë ata vazhdonin të qeshnin me marifetin që çoç kishin sajuar. Resulullahu që larguar goxha prej tyre, mirëpo këmbët ia kishte mbuluar gjaku. Më në fund, ai arriti të strehohej në një vresht rrushi. Po dridhej nga dhimbjet dhe nga mërzia, gjeti një hije dhe u ul. Këmbët vazhdonin t'i rridhnin gjak, nuk kishte të reshtur gjithë ai gjak. Kur hyri në atë vresht, aty ishin edhe dy djemtë e Rabias, Utbeja dhe Shejbeja. Profeti (alejhis'selam), kur i pa, nuk deshë t'u shkonte pranë, sepse e dinte që ata ishin ndër armiqtë e tij më të paepur. Utbeja dhe Shejbeja i dhanë disa veshë rrushi skllavit të tyre nga Niniva, Adasit, i cili ishte i krishterë, dhe i thanë që t'ia çonte ata Profetit tonë. Adasi ia çoi rrushin dhe ia vuri përpara, ndërsa Profeti ynë tha:

- "Bismil'lah."

Kjo ishte një fjalë që e habiti tej mase Adasin.

- "Nga je ti kështu?", – e pyeti Resulullahu.

- "Jam nga Niniva!", – u përgjigj Adasi.

- "Pra, ti qenkëshe patrioti i njeriut të mirë, Junus bin Metasë, apo jo?"

- "Nga e di ti emrin e Junus bin Metasë?", – e pyeti ai të Dërguarin e Allahut, i cili i tregoi shumë gjëra të reja, të cilat ai nuk i kish dëgjuar kurrë më parë në lidhje me profetin Junus.

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti ynë i ka thënë:

- "Ai është vëllai im, sepse ai është një profet. Edhe unë jam profet, njësoj si ai."

Profeti ynë i Dashur (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur kryente detyrën e profetësisë, atë të përhapjes së fesë së vërtetë të Allahut, nuk nënvlerësonte askënd. Adasi iu përgjigj:

- "O Resulullah, a do të më flasësh mua më shumë për Junus bin Metanë?"

I Dërguari i Allahut i mësoi atij ajetet që i ishin zbritur lidhur me jetën e Junusit të nderuar (alejhis'selam), Adasi u përul në

sexhde para Resulullahut dhe filloi t'i puthte këmbët, të cilat i kishte ende të mbuluara në gjak. Utbeja dhe Shejbeja nuk reagueshan për sjelljen e shfaqur nga skllavi i tyre. Kur Adasi shkoi pranë tyre, ata i thanë:

- "Ç'e ke këtë gjendje? Çfarë ishte gjithë ajo përulësi e tërë ai respekt para Muhamedit, që i puthe edhe këmbët? Mes nesh ne nuk e kemi parë kurrë një sjellje si kjo!"

Adasi iu përgjigj atyre duke u thënë:

- "Ky është një njeri shumë i mirë, Ai më foli mua për të vërtetat e Junus bin Metasë, profetit që Zoti i pati dërguar qytetit tonë, madje e dinte se Junusi ishte i dërguar i Zotit."

Utbeja dhe Shejbeja qeshën pak me njëri-tjetrin dhe e paralajmëruan:

- "Bëj kujdes se mos të bën të braktisësh Krishterimin; ai është njeri shumë hileqar!"

Që aty, Profeti i profetëve u kthye prapë në Mekë."

### **Lutja që bëri i Dërguari i Allahut teksa kthehej nga Taif**

Sipas asaj që na përcillet, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shpëtoi paq nga banorët e Taifit dhe kur gjeti një vend më të sigurt, Ai bëri këtë lutje:

"O Zot! Nuk mund të të ankojem veçse Ty për pafuqinë, që jam kaq i dobët e që njerëzit më shohin me kaq shumë përbuzje. Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve, Ti je Zoti i atyre që nuk kanë asnjë mbështetje! Ti je Zoti im. Ti do të më mëshirosh mua, sa të mos më lësh në duart e dikujt që më vrenjt fytyrën, apo që të më lësh në duart dhe mëshirën e munguar të armiqve! Mjafton që Ti të mos jesh i mërzitur me mua, pa asgjë tjetër nuk më intereson. Mua më mjafton shëndeti dhe përkujdesja që do të më falësh Ti dhe e di se ajo është shumë herë më e madhe se sa këto që po përballëm. Unë strehimin e kërkoj tek ai nuri Yt që ndriçon dhe i jep jetë kësaj bote e jetës së përjetshme, duke e bërë dritë errësirën, që të mund të shpëtoj prej ndëshkimit Tënd; të mos e meritoj atë ndëshkim. Nuk do të largohem nga pragu i portës Sate derisa Ti të kesh mbetur i kënaqur me mua. Vetëm tek Ti e ka burimin e tërë forca dhe fuqia dhe sajë Teje gjithçka arrin të qëndrojë në këmbë."

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"  
M. Jusuf Kandehleui  
Botim i KMSH**

# Puna dhe prona në optikën e fesë Islame

Feja islame, si sistem edukimi dhe mënyrë jetese, nuk kujdeset vetëm për sferën shpirtërore të njeriut, sepse duke qenë njëkohësisht një sistem praktik, përmbledh besimin, ashtu edhe jetën, ose sa vlerëson idealen, aq kërkon të përfilllet dhe materialja. Brenda këtij koncepti mjaft të pranueshëm për arsyen, Islami e sheh individin gjithmonë në kompleks, e para së gjithash në marrëdhënie me njerëzit dhe i dikton atij rregullat e veta për ta ndihmuar të gjejë rrugën e drejtë, jo vetëm në aspektin individual e shpirtëror, por edhe në atë shoqëror, ekonomik e politik.

Në Kur'an njeriut i thuhet: "Unë do të vendos mëkëmbës në tokë" (2:30). Kjo barrë, të cilën e mori përsipër njeriu, e ngarkon atë me përgjegjësinë e madhe për ta bërë botën të lulëzuar në çdo aspekt. Prandaj njeriut i është dhënë aftësi e liri e plotë mendore për studimin e kësaj bote materiale, në mënyrë që, nëpërmjet punës së vazhdueshme, të kërkojë e të zbulojë çdo gjë, e cila mund ta bëjë gjithnjë e më shumë zotëruar të saj. Për këtë arsye, feja islame nxit në masat e pasuesve të saj punën dhe çdo veprimtari tjetër aktive që çon në përmirësimin e kushteve të jetës. Puna konsiderohet si një aktivitet parësor, i cili ka një funksion sa moral, aq edhe material, sepse ajo është sa faktor lufte kundër

mendimeve dhe pasioneve të këqija, po aq edhe faktor kundër varfërisë për të cilën profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Varfëria e çon njeriun deri në mohim të Zotit dhe mosmirënjohje..."

Prandaj myslimanët me moshë madhore, veçanërisht ata që kanë në ngarkim familje, e kanë për detyrë të punojnë e të përdorin aftësitë dhe burimet që i ka falur Zoti për të siguruar jetesën me mundin dhe djersën e tyre.

Islami mbështet fuqishëm devizën: "Në djersën e fytyrës tënde do të hash bukën tënde" dhe dënon papunësinë pa shkaqe madhore, përtacinë, lypjen, apo pritjen e lëmshës prej të tjerëve, të cilat i prishin njeriut karakterin, e vënë nën varësi, duke i mohuar kështu lirinë dhe vetëveprimin. Për të evituar të këqijat që sjellin këto feja jonë nuk e këshillon dhënien e lëmshës, përveç rasteve kur ajo jepet si ndihmë për atë që ndodhet në vështirësi të vërteta dhe jo për faj të tij. Ndiha dhe mbështetja ekonomike në këto raste, përcaktohet si detyrë e çdo myslimani. Por, dihet se askush nuk e shijon më shumë ushqimin sesa ai që e ka siguruar me djersën e vet. Prandaj Islami këshillon që myslimani të mos mendojë kurrë se mjerimi mund të shmanget duke shpresuar në ndihmën e të tjerëve. Konkretisht, sot, për shqiptarin

po bëhet gjithnjë e më e qartë se asnjë individ apo shtet ekonomikisht i fortë, nuk i shpenzon paratë e tij në Shqipëri pa pasur të siguruar një përfitim material ose politik. Nga ana tjetër, pushteti i diktaturës së proletariatit i mësoi njerëzit të punojnë pak e të kënaqen me varfërinë e asaj page që i mbante gjallë, por nuk i pasuronte kurrë. E katandisi fshatarin në atë gjendje sa të kishte ushqim bazë bukën e misrit dhe gjellë dhallin ose sherbetin. Në këtë mënyrë i bëri të kuptojnë punonjësit se tani djersa e tyre e harxhuar në punë, nuk i sillte më fitimin e merituar. Kjo çoi në shmangien ndaj punës së vërtetë dhe kultivoi tek ata indiferentizmin ndaj punës, pastaj dembelizmin dhe për pasojë hilen e vjedhjen. I detyroi të kompensojnë nevojat e domosdoshme të jetës me vjedhjen fillimisht të çdo produkti që prodhonte dhe pastaj të çdo gjëje që ishte pronë e të gjithëve, duke e vënë kështu individin kundër shoqërisë, pasojat më të tmerrshme të të cilit i pamë gjatë kalimit të pushteteve. Të gjitha këto çuan në shndërrimin e shumë virtyteve në vese, të cilat pa dashur e gradualisht u përvetësuan dhe u shndërruan në norma dhe krijuan te shqiptari një varfëri shpirtërore nga zhveshja e shumë vlerave morale të çmuara të trashëguara nga brezat e mëparshëm.

Duke e konsideruar punën shumë të dobishme dhe moralisht të ndershme, profeti Muhamed a.s. në kohën e tij këshillonte: "Është më mirë që secili prej jush të marrë një litar dhe të ngarkohet me dru për t'i shitur sesa t'ua lypë ushqimin të tjerëve, pa marrë parasysh nëse japin ose jo". Sot, te ne, shohim jo pak të rinj e familjarë, të cilët, pa ndrojtje dhe në mënyrë të ndershme, e sigurojnë jetesën duke shitur vetëm pak produkte të konsumit të shpejtë. Por shohim njëkohësisht mjaft të tjerë, të cilët e konsiderojnë turp një veprim të tillë. Duke qëndruar kot me shokët trotuareve, në qoftë se nuk merren me gjëra imorale, më e pakta që bëjnë është përgojimi i të tjerëve, ose më keq, e vrasin kohën me lojëra të padobishme e moralisht të ndaluara. Natyrisht, është detyrë edhe e shtetit në këtë periudhë që të krijojë mundësi punësimi.

Edhe çudirat për Islamin nuk ekzistojnë si mrekulli, por krijohen nga vetë njerëzit. Më të përkryera dhe të çmuara janë vetëm ato që arrihen nëpërmjet përsosjes së mjeteve të punës e të prodhimit. Prandaj kurrë nuk duhen pritur mrekulli të cilat mund të largojnë në mënyrë të çuditshme varfërinë e atij që duke u ngrohur në diell, sheh ëndrra me sy hapur. As shpresat e gënjeshtërtë në lojërat e fatit, as bixhozi nuk e zhdukin varfërinë. Në lotari humbasin mijëra dhe fitojnë më shumë organizatorët dhe disa individë. Shpresat e vazhdueshme për disa fitore të rastit që mund të mos arrihet kurrë, të çojnë vetëm në pasivitet. Akoma më e keqe është loja e bixhozit, e cila


përfundon me humbje morale e materiale të rënda. Prandaj të dyja këto Islamin i dënon dhe i ndalon.

Sot ndodh shpesh që shumë familjarë, të detyruar nga kushtet e vështira ekonomike, detyrohen të kërkojnë borxhe për të përballuar jetesën, ose për të filluar një punë fitimprurëse. Islami e lejon në të tilla raste borxhin (asnjëherë me kamatë), por këshillon që ai të evitohet sa më shumë. Marrja e borxhit, e mbështetur gjithmonë në një kontratë ku përcaktohet afati i kthimit, kur për arsye të ndryshme nuk respektohet, krijon shqetësime të forta e tensione psikologjike, jo vetëm tek individ, por për pasojë dhe në familje e shoqëri. Duke i vlerësuar shumë pasojat e borxhit, Muhamedi a.s. ka thënë: "Zoti më ruajttë prej mëkateve dhe borxheve!" Prandaj, për të ruajtur dinjitetin dhe lirinë tënde, Islami këshillon të mos marrësh borxhe, por me punën dhe me një fitim të vogël, planifiko drejt shpenzimet.

Kush punon, fiton dhe mundet të sigurojë veç mjeteve të nevojshme të jetesës edhe pasuri, e cila në fenë islame konsiderohet një dukuri normale dhe mjaft pozitive. Por ajo përcakton kufij për atë, cakton taksa për çdo pronar, të cilat rriten në proporcion me pronësinë dhe fitimin dhe venë si detyrë parësore fetare shlyerjen e zekatit, ku çdo mysliman pastron pasurinë e tij nga teprica. Të gjitha këto vihen në shërbim të shoqërisë dhe kryesisht të të varfërve. Kërkon gjithashtu që pasuria e fituar në para të vihet në qarkullim në ato veprimtari ekonomike që favorizojnë shoqërinë dhe të mos mbahet e bllokuar në ar, etj. Pasurinë e patundshme që krijon çdo individ me punën dhe djersën e tij, feja islame e mbron dhe ndalon përvetësimin nga të tjerët edhe në ato raste kur padrejtësisht mund të bëhet në rrugë ligjore. Nuk përkrah gjithashtu idenë e privatizimit të burimeve të mëdha të pasurive shoqërore e sidomos të burimeve natyrore, duke i lënë ato në duar individësh. Ato duhet t'i shërbejnë shoqërisë, duke mbetur pronë e bashkësisë (shtetit) për t'i shërbyer të gjithë anëtarëve si bazë materiale për të mbështetur zhvillimin e sferave të ndryshme të jetës.

Nëpërmjet këtyre pikëpamjeve dhe qëndrimit shumë të arsyeshëm mbi punën dhe pronën, Islami, pa penguar lirinë e mendimit dhe veprimin individual të njeriut për të fituar të mira materiale, kërkon që këto t'i shërbejnë jo vetëm atij, por tërë shoqërisë. Duke e parë të pleksur besimin me jetën, duke e konsideruar punën e ndershme si kolona që mban në ekuilibër shpirtëroren me materialen, Muhamedi a.s. ka urdhëruar: "Çdo myslimani i është detyrimisht e shenjtë dhe e paprekshme jeta, pasuria dhe nderi i jetrit."

**Shpëtim Salihu**



(1852-1915)

## Hoxhë Hasan Moglica

**Një atdhetar me përmasa mbarëkombëtare, luftëtar dhe dijetar i shquar**

Hasan Shermeti (Sula), i mbiquajtur Hoxhë Moglica, lindi në Moglicë të Dibrës në vitin 1852, ndërkohë që prindërit e tij kishin ardhur në Okshtunin malor nga Dibra e Madhe. Hasan Moglica ka ndjekur studimet fillimisht në mejtepin e Peqinit e më pas medresenë e Elbasanit, ku pas tyre do të vazhdonte shkollimin në Universitetin e Stambollit, me qëllimin final për t'u rikthyer e për t'i shërbyer vendit të tij.

Shtëpia e tij u bë bazë e rëndësishme dhe strehë për të gjithë atdhetarët e asaj kohe. Në këtë kuadër, Hoxhë Moglica, rreth viteve 1887-1900, zhvilloi një veprimtari politike e atdhetare kundër synimeve shoviniste të fqinjëve serbo-bullgarë. Kjo veprimtari i kaloi kufijtë e Okshtunit dhe u shtri pothuaj në të gjitha fshatrat e Gollobordës e më gjërë.

Ndërkohë, për të përballuar çdo rrezik e të papritur, me nismën dhe nën drejtimin e Hasan Moglicës, u formua një njësit vetëmbrojtje ku bënin pjesë shumë bashkëfshatarë të tij.

Ndërkohë, pas vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit për çështjen shqiptare, ngjarjet në Ballkan rrodhën në mënyrë të atillë që të krijoheshin kushtet për mbrojtjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku së bashku me delegatët e tjerë të Dibrës, mori pjesë dhe Hoxhë Moglica. Ai shoqëroi në krahinën e Gollobordës dhe në Okshtun, ideologun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit Abdyl Bej Frashërin, i cili pasi bujti dy net në shtëpinë e Hoxhë Moglicës, u shoqërua nga ky i fundit për në Teqen e Martaneshit. Veprimtaritë për zbatimin

e vendimeve të Lidhjes e bënë Hasan Moglicën akoma më të njohur në Dibër, Elbasan, e sidomos në Gollobordë. Jo rastësisht ai do të ftohet në të gjitha kuvendet e Dibrës, në Kongresin e II të Manastirit, në Kongresin e Elbasanit dhe në Kuvendin e Fushë Klenjës, ku u bën thirrje bashkëkombësve të tij për përhapjen e gjuhës shqipe.

Pas reputacionit që krijoi figura e Hoxhë Moglicës, iu ofrua detyra e Myderrizit në zonën e Gollobordës, ku nën këtë petk zyrtar kryente më lehtë detyrën patriotike. Më 1909, Hoxhë Moglica mori pjesë në Kongresin e Elbasanit, ku midis të tjerave u vendos edhe hapja e Shkollës Normale për të përgatitur mësues për gjuhën shqipe. Si inspirues dhe delegat i këtij kongresi, Hasan Moglica organizoi shumë kuvende ku propagandonte vendimet e këtij Kongresi. Ndër këto me rëndësi, është ai i Fushës së Klenjës. Për këtë, patrioti dhe publicisti Haki Stërmilli shkruan: "Hoxhë Moglica e mblodhi popullin e Gollobordës e mbasi ua shpjegoi gjatë e gjerë vendimet e marra në Manastir, u foli mbi rëndësinë e Shkollës Normale të Elbasanit dhe përfundoi tue kërkue prej çdo dere të parisë së Gollobordës të dërgonin nga një djalë në këtë shkollë. Mbasi i dhanë të gjithë besën se fjalët e tij do të realizoheshin, mbledhja u shpërnda krejt entuziaste nga fjalët e Hoxhës, tue qit edhe pushkë nga gëzimi pushtues"<sup>1</sup>.

Më 1879, kur mbaroi studimet e larta në Universitet në Stamboll, me rezultate të shkëlqyera do të shkruhej për të: "Stambolli nëpërmjet Hasan Moglicës i ka dhënë Shqipërisë mësuesin e fesë Islame". Është për t'u nënvizuar se përveçse një dijetar, klerik dhe atdhetar i flaktë, Hasan Moglica ishte edhe një projektues e inxhinier me zë në të gjithë krahinën e Dibrës. Ai projekttoi kanalin e famshëm të vaditjes në lagjen Ballaj, muri i të cilit ngrihet mbi një shkëmb të thepisur 9 metra të lartë. Ai ndërtoi për herë të parë mbi lumin e Okshtunit të parën Valanicë për ngjeshjen dhe përpunimin e shajakut si dhe një farkë (kovaçhanë) për mjetet dhe armët e luftimit etj.; ndërsa shpella te Shkëmbi i Patës, ishte shtëpia e dytë e tij.

Me dashurinë për librin, që ndihmonte në hapjen e dritës së diturisë, me shpenzimet e tij dhe me ndihmën e miqve që i kishte kudo, Hoxhë Moglica e ktheu shtëpinë prej 28 dhomash në Moglicë në një bibliotekë-shkollë, krahas shkollës osmane që e kishte hapur tek Ara e Martinut që në vitin 1904.

Me gjithë dëshirën e madhe të Hasan Moglicës për të marrë pjesë në shpalljen e pavarësisë më 1912 në Vlorë, për arsye të ndjekjes nga pushtuesit serb, nuk mundi t'u bashkëngjitet delegatëve dibranë, por i entuziazmuar për këtë eveniment, ngriti flamurin mbi çatinë e shtëpisë në prani të njerëzve dhe bashkëfshatarëve të tij. Pas shpalljes së Pavarësisë, Hoxhë Moglica do të ndodhej para pushtuesve të tjerë të egër serbo-bullgarë.

Më 1914 atë e kapën esadistët, e burgosën dhe e keqtrajtuuan, pa marrë parasysh moshën, autoritetin dhe petkun fetar që kishte. Por me gjithë presionin dhe torturat që përdorën ata ndaj Hoxhës, ai nuk u mposht e nuk u thye, dhe pas 3 muajsh tortura të egra, kur serbët iu afruan postave

të Elbasanit, Hoxhë Moglica arriti të arratisesh nga burgu me ndihmën e shokëve e miqve të tij dhe në fillimin e vitit 1915 u kthye në Okshtun.

Edhe pas kthimit në vendlindje, serbët e ndoqën këmbakëmbës. Ata dhanë shuma të konsiderueshme për të zbuluar vendndodhjen e tij, ndërkohë që shtëpinë ia dogjën dhe familja u largua në fshatrat e Çermenikës. Serbët mundën t'i kapin djalin e vetëm që kishte, Osmanin, i cili kishte mbaruar normalen e Elbasanit dhe kryente detyrën e mësuesit të gjuhës shqipe. Patrulla serbe i solli të lidhur djalin duke i bërë presion që të dorëzohej. Hoxha gjykoj se "meqenëse ata po më lirojnë djalin e vetëm, do të "dorëzohem" se unë di si të qëndroj". Ndërkohë serbët lirojnë Osmanin dhe arrestojnë Hoxhën dhe bashkëpunëtorin e tij të ngushtë Abdi Sollakun, duke i vënë si kusht për lirim firmosjen e një deklaratë sipas së cilës, rajoni nga Fusha e Kolgrecut në perëndim në Kaptinë, në Vervjak, Qafë Buall dhe Qafë-Murrë, e më tej në Lurë të quheshin toka serbe.

"Nëse do të firmosej deklarata nga Hoxhë Moglica, serbët jo vetëm do ta lironin, por ai do të përfitonte shpërblime dhe ofiqe të majme"- shkruhej në revistën "Zani i Naltë" (nr. 11, viti 1937). Atdhetari e priti me neveri këtë propozim, duke thënë: "Mos m'i lidhni sytë se një ditë do të hapen, më lejoni të shikoj edhe një herë malet dhe luginat e Dibrës nga Korabi, Kurora e Lurës, Mali i Bardhë, Verviaku, Kaptina, e deri në Thellësi të Malit të Babjes, se andej e shikoj agimin për një Shqipëri të lirë e të pavarur. Rroftë Shqipëria! Rroftë Flamuri!... Por plumbat ia prenë fjalën në mes, e trimat ranë në gropën që e kishin hapur me duart e tyre nën kërcënimin e bajonetave serbe. Ndonëse shpirti akoma nuk u kishte dalë e ende përpëliteshin, pushtuesit u hodhën dhe sipër. Tre ditë më vonë, pasi u largua komanda serbe nga Kodër-Moglica, familjarët, të afërmit e fshatarët i morën kufomat e të pushkatuarve dhe i varrosën, ku Hoxha u varros në Varrezat e Sulajve në Moglicë.

Hoxhë Moglica në vitin 1975 është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor si Patriot e Atdhetar i shquar dhe eshtrat e tij prehen në Varrezat e Dëshmorëve në Peshkopi.

Jo rastësisht dekorimi i tij është bërë me rastin e 50 vjetorit të pavarësisë dhe në të njëjtin urdhër dekorimi krahas me Ismail Qemalin, Abdyl, Sami dhe Naim Frashërin, me Iljas Pashë Dibrën, Dom Nikollë Kaçorrin, Vehbi Dibrën, me Isa Boletinin, Luigj Gurakuqin, Mihal Gramenon dhe Çerçiz Topullin dhe me dhjetëra atdhetarë të shekujve XIX-XX.<sup>2</sup>


Gazeta "Dibra" në anketën e saj "Dibrani i shekullit XX" organizuar në fundshekullin e XX shpalli Hoxhë Moglicën "Dibrani i shekullit", në një kohë kur ishin në "garë" dhjetëra atdhetarë dhe njerëz të shquar të Dibrës, kontributi i të cilëve ka qenë dhe mbetet mbarëkombëtar.

Si i tillë, Hoxhë Moglica është dhe do të mbetet krenaria e të gjithë shqiptarëve, një atdhetar dhe një dijetar me përmasa mbarëkombëtare.

1. Stërmilli, Haki, "Dibra në pragun e Historisë", 1940: 53.

2. Cami, Sakip, studiuues i jetës dhe veprës së Hoxhë Hasan Moglicës.

# Unë të besoj *o i Dërguari i Allahut*



Qabeja është vend i shenjtë. Ajo është ndërtuar nga Hazreti Ademi dhe e restauruar nga Hazreti Ibrahim.

Meka është vendi i shenjtë që nga koha e njeriut dhe profetit të parë. Këtu janë ngritur panairë të ndryshme, pasi ishte vend i begatë. Në këtë qytet vinin karvanet nga shtetet fqinje dhe qytetet e tjera.

Në një nga lagjet e Mekës ndodhi kjo ngjarje...

Një pasdite kur fëmijët po përfundonin lojën e tyre dhe zogjtë po iknin një nga një në çerdhe, papritur një fëmijë dhe ky ishte Enesi, u nda nga grupi i bashkëmoshatarëve. Në vend që të shkonte në shtëpi, u nis drejt tregut. Kur mbërriti pranë kodrës safa, vuri re se një grup njerëzish, të cilët rrethonin një njeri.

Diçka paska ndodhur..."- mendoi me vete Enesi dhe kureshtja e ftoi t'i drejtohej turmës.

Me t'u afruar, dalloj një njeri. Ai po ligjeronte para njerëzve.

"Po, ky është Muhamedi, I Besueshmi! Çfarë thotë vallë?.." mendoi përsëri me vete.

Enesi u afrua dhe dëgjoi më qartë fjalët e Tij.

-O populli Kurejsh! Nëse u them se pas këtij mali keni armiq të tuaj që do t'iu sulmojnë dhe do t'iu grabisin mallrat, a do të më besoni?..

Të gjithë njerëzit bashkë me Enesin thanë:

-Të besojmë! Deri tani, nuk na ke gënjyer. Ti je njeri i sigurtë! Ti je më i besueshmi dhe më i rregullti ndër ne!

-Atëherë unë po ju them se, mua më ka dërguar Allahu i Lartëmadhëruar për t'ju udhëzuar në rrugën e drejtë.

Papritur ra heshtja. Të gjithë shihnin njëri-tjetrin të habitur. Kishin marrë një ftesë të papritur...

Heshtjen e theu Ebu Lehebi, Xhaxhai i Muhammedit a.s, i cili përdori fjalë të rënda e të pahijshme kundër nipit të tij.

Pas këtij qëndrimi të ashpër të Ebu Lehebit, njerëzit nisën të shpërndaheshin, të pavendosur dhe të habitur. Sikur s'po kuptonin asgjë. Vështronin Ebu Lehebin, i cili ngjante i vetmuar.

Muhamedi a.s, zbriti nga kodra Safa dhe hodhi një shikim dashamirës Enesit që kishte mbetur i çuuditur dhe kishte rënë në mendime të thella.

Ai nuk ia ndante vështrimin Muhamedit a.s dhe nga zemra i dolën këto fjalë:

-Unë të besoj, o i Dërguari i Allahut!...

**Redaksia**



# PËRZGJIDH KOLEGJIN UNIVERSITAR BEDËR NË PORTALIN U-ALBANIA



## FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË

- Drejtësi
- Gazetari dhe Komunikim Multimedial
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu
- Shkenca Islame
- Multimedia dhe Dizajn Grafik

## FAKULTETI I TEKNOLOGJISË DHE BIZNESIT

- Finance Kontabilitet
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Kompjuterike
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Programim në Web

[www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al)

